

CORRUPTION SCAN

HULUMTIM I OPINIONIT PUBLIK

Njohuritë, Qëndrimet dhe Përvojat e
Qytetarëve rreth Korrupsionit në Kosovë

CORRUPTIONSCAN

HULUMTIM I OPINIONIT PUBLIK:

Njohuritë, Qëndrimet dhe Përvojat
e Qytetarëve rreth Korrupsionit në Kosovë

Realizimi i këtij hulumtimi është mundësuar me përkrahjen e Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë. Mendimet e shprehura në këtë raport nuk i paraqesin medoemos pikëpamjet e Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë.



British Embassy
Pristina

Përmbajtja

Hyrje **4**

Metodologjia **6**

Përmbledhja Ekzekutive **8**

Opinionet e qytetarëve mbi problemet më të rëndësishme në Kosovë **12**

Opinionet e qytetarëve rreth pranisë së korrupsionit në institucionet/sectorët publik **14**

Opinionet e qytetarëve mbi sjelljet e ndryshme korruptive **17**

Përvojat e qytetarëve në dhënien e ryshfetit për marrjen e shërbimeve publike **20**

Njohuritë e qytetarëve rreth mënyrave vijuese të sjelljeve në mesin e zyrtarëve publik **22**

Njohuritë e qytetarëve rreth mënyrave vijuese të sjelljeve në mesin e politikanëve **23**

Perceptimi i qytetarëve mbi nivelin e korrupsionit në Kosovë **25**

Përvojat e qytetarëve në raport me shërbimet publike **26**

Përvojat me ryshfet **32**

Qëndrimet dhe përvojat e qytetarëve në lidhje me raportimin e korrupsionit në institucione përgjegjëse **37**

Përvojat e qytetarëve në procesin e punësimit në sektorin publik **43**

Të dhënat demografike të hulumtimit **45**

Aneks – Tabelat e përgjigjeve të qytetarëve në bazë të regjioneve **48**

Falënderime **85**

Rreth Lëvizjes FOL **87**

Hyrje

Synimet për një qeverisje demokratike në Kosovë nuk janë shoqëruar njëherazi me rritje të besueshmërisë së qytetarëve në institucionet publike dhe partitë politike. Përkundrazi, për afro dy dekada me radhë, niveli i besueshmërisë së qytetarëve në institucione ka pësuar një rënie të vazhdueshme. Ky konstatim, përveç që është verifikuar nga shumë studime brenda e jashtë Kosovës, ka një pranueshmëri edhe nga vetë elita institucionale dhe ajo politike në vend. Sidoqoftë, edhe pse udhëheqja politike ka qenë dhe është e vetëdijshme për këtë nivel mosbesueshmërie, ajo fare pak është interesuar në adresimin e shkaqeve që kanë sjellë deri te një krizë e fillë legjitimitetit. Padyshim që ndër shkaqet kryesore të kësaj krize janë: demokracia e brishtë institucionale, problemet strukturore ekonomike, mosrespektimi i të drejtave të njeriut, qasja jo e duhur në shërbimet publike dhe një varg çështjesh të tjera që ndër lidhen kryesisht më marrëdhëniet qytetarë-institucione.

Duke qenë të mirëinformuar dhe të vetëdijshëm për këtë gjë, Lëvizja FOL, përmes këtij hulumtimi të opinionit publik, është duke provuar të hedhë më shumë dritë sa i përket marrëdhënies së qytetarëve me institucionet publike, dhe në këtë mënyrë të kontribuojë në përmirësimin e legjitimitetit qytetar karshi institucioneve publike.

Hulumtim analizon nivelin e besueshmërisë së qytetarëve në institucionet publike të Republikës së Kosovës. Më specifikisht, hulumtimi analizon perceptimin e qytetarëve sa i përket nivelit të lartë të korrupsionit në vend. Në pjesën e parë të hulumtimit, qytetarët janë pyetur për të bërë identifikimin e problemeve kryesore me të cilat Kosova është duke u ballafaquar momentalisht. Fillimisht, qytetarët janë pyetur rreth pranisë së korrupsionit në institucionet apo sektorët më të rëndësishëm publikë. Në këtë pikë, qytetarët janë pyetur për të bërë renditjen e institucioneve më të korruptuara, varësisht nga niveli i njohurive dhe përvojave të tyre personale.

Më pas, hulumtimi është fokusuar për të kuptuar nëse sjelljet korruptive janë apo nuk janë të pranueshme për qytetarët e Kosovës. Në këtë pikë, qytetarëve u është ofruar një listë me sjellje korruptive, dhe mbi bazën e saj qytetarët janë pyetur se cilat nga sjelljet korruptive janë apo nuk janë të pranueshme.

Përveç kësaj, hulumtimi ka analizuar nëse për marrjen e shërbimeve publike qytetarët është dashur të japin para apo dhurata shtesë, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë, qoftë në mënyrë të tërthortë. Ata, po ashtu, janë pyetur rreth shpeshësisë së sjelljeve të zyrtarëve publikë në punësimin e miqve apo të afërmeve të tyre në sektorin publik, si dhe se sa ata mendojnë që zyrtarët publikë shfrytëzojnë mjetet apo pronën publike për nevoja personale apo familjare.

Gjithashtu, hulumtimi analizon perceptimin e qytetarëve sa i përket

nivelet të korrupsionit në Kosovë në tre vitet e fundit. Në këtë pikë, qytetarët janë pyetur nëse në tre vitet e fundit është rritur niveli i korrupsionit, nëse ka mbetur i njëjtë, apo është zvogëluar. Më tej, qytetarët janë pyetur nëse kanë hasur në sjellje të ndryshme korruptive, dhe nëse po atëherë është shikuar nëse ato i kanë lajmëruar tek institucionet përgjegjëse për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit.

Së fundmi, qytetarët janë pyetur rreth përvojave të tyre në procesin e punësimit në sektorin publik dhe mundësi të identifikimit të keqpërdorimeve gjatë këtyre proceseve. Në këtë pikë, qytetarët e anketuar janë pyetur nëse kanë konkurruar për ndonjë vend pune në sektorin publik, ata ose ndonjë anëtar i familjes së tyre, së paku një herë në 3 vitet e fundit. Specifikisht, ata janë pyetur se kur kanë konkurruar për herë të fundit dhe nëse eventualisht e kanë fituar atë punë. Ata që janë përgjigjur se kanë konkurruar për një vend pune në sektorin publik dhe që janë punësuar, janë pyetur nëse është dashur që të japin ryshfet ose të ofrojnë ndonjë shërbim tjetër në këmbim të punësimit të tyre. Ndërsa ata që nuk kanë mundur të punësohen në sektorin publik, janë pyetur mbi arsyet se pse ata ose anëtarët e familjeve të tyre nuk kanë arritur të punësohen në pozitat që kanë aplikuar në sektorin publik.

Metodologjia dhe mostra e hulumtimit

Hulumtimi, i titulluar “CorruptionSCAN” - Hulumtim i Opinioneve Publik: Njohuritë, Qëndrimet dhe Përvojat e Qytetarëve mbi Korrupsionin në Kosovë” është zhvilluar në 38 komuna të Kosovës duke përdorur metodën sasiore të hulumtimeve. Për përcaktimin e mostrës në këtë hulumtim është përdorur teknika e “mostrës së shtresuar të rëndomtë,” me ç’rast popullata e përgjithshme është ndarë në grupe më të vogla që në literaturë njihen si shtresa varësisht nga karakteristikat e përbashkëta të pjesëtarëve të këtyre shtresave. Shtresimi i parë është bërë në bazë të përkatësisë etnike, ku janë krijuar tri nën-grupe të ndryshme. Shtresimi i dytë është bërë në bazë të vendbanimeve; për secilën komunë është bërë shtrirja e mostrës në pjesët urbane dhe rurale, sipas statistikave zyrtare të ASK-së. Shtresimi i tretë është bërë në bazë të numrit të anketave të realizuara në secilin vendbanim (pika startuese). Pikat startuese në këtë hulumtim janë përcaktuar sipas metodës së rastësisë. Koha e realizimit të hulumtimit është zhvilluar në teren nga data 10 deri me 28 Maj 2015. Ky hulumtim ka nivel të besueshmërisë prej 95% me marzhë të gabimit +-3.1%.

Në kuadër të këtij hulumtimi janë anketuar 1000 qytetarë të Kosovës; rreth 93% e të anketuarve kanë qenë nga komuniteti shqiptar, 4% nga ai serb, 1.2% ashkalinj, 0.5% goran, 0.5% turq, 0.4% boshnjak dhe 0.4% rom.

Mostra më pas është peshuar, për të reflektuar strukturën etnike në Kosovë. Para se të administrohet pyetësi në teren fillimisht është bërë testimi i pyetësorit për të identifikuar problemet logjike dhe përmbajtësose, si dhe është zhvilluar trajnimi i anketuesve.

Përzgjedhja e të anketuarve është bërë përmes këtyre tre fazave:

FAZA E PARË

Përzgjedhja e shtëpisë përmes teknikës së ecjes sistematike të rastit

Në këtë fazë anketuesi nga pika startuese ka përzgjedhur çdo të tretën shtëpi në anën e majtë të rrugës. Në rastet kur shtëpia ka qenë e pabanuar ose kur anketuesi është refuzuar, njësia e banimit është kaluar dhe është vazhduar me qasjen sistematike.

FAZA E DYTË

Pyetjet përjashtuese - Identifikimi i kandidatit të përshtatshëm për intervistë

Në këtë fazë është bërë identifikimi dhe kontaktimi i kandidatit të përshtatshëm për intervistë. Për këtë fazë, UBO Consulting ka përzgjedhur anëtarin me moshë mbi 18 vjeçare dhe që ka datëlindjen e ardhshme më së afërmi.

FAZA E TRETË

Zhvillimi i intervistave ballë-për-ballë

Gjatë përgatitjes për intervistë, intervistuesi ka sqaruar rëndësinë e të përgjigjurit në bindjet personale të të intervistuarit, ku preferencë i është dhënë që intervista të realizohet pa prezencën e anëtarëve të tjerë të familjes.

Në kuadër të këtij hulumtimi janë përfshirë gjithsej 28 anketues dhe 7 mbikëqyrës regjionale të cilët kanë monitoruar në baza ditore punën e anketuesve në teren. Kontrolli i cilësisë së anketimit është bërë edhe pas përfundimit të punës në teren, përmes verifikimit (thirrjeve telefonike dhe vizitave) të 30% të anketave të realizuara. Të dhënat e grumbulluara janë përpunuar në programin SPSS, prej edhe nga janë fituar rezultatet e këtij raporti.

Përmbledhja Ekzekutive

Në këtë hulumtim qytetarët e Kosovës janë pyetur fillimisht për të bërë identifikimin e tre problemeve kryesore. Sipas t

ë gjeturave të hulumtimit rezulton se në renditjen e përgjithshme rreth 52.80% e qytetarëve problemin kryesor e konsiderojnë papunësinë në vend, rreth 39.70% e tyre mendojnë që korrupsioni është njëri nga problemet kryesore si dhe rreth 34.40% e qytetarëve mendojnë që performanca e dobët e Qeverisë së Kosovës është njëri nga problemet kryesore në vend.

Gjatë këtij hulumtimi qytetarët janë pyetur po ashtu rreth pranisë së korrupsionit në institucionet publike. Në këtë pikë, siç tregojnë të dhënat e hulumtimit, rreth 40.30% qytetarëve të anketuar mendojnë se korrupsioni është më së shumti i shtrirë në Qeverinë e Kosovës, 27.90% mendojnë se korrupsioni është më së shumti i shtrirë në parti politike, ndërsa rreth 26.10% e qytetarëve mendojnë që korrupsioni është më së shumti i pranishëm në sistemin gjyqësor.

Qytetarëve të anketuar u është paraqitur njashtu një listë e sjelljeve korruptive, me qëllim të testimit nëse sjelljet korruptive janë apo nuk janë të pranueshme për qytetarët. Siç demonstrojnë të gjeturat e hulumtimit, për shumicën e qytetarëve sjelljet korruptive janë të papranueshme. Rreth 78% e qytetarëve, për shembull, e kanë konsideruar si të papranueshme sjelljen e arsimtarëve ose profesorëve të cilët kërkojnë para për t'u sjellë më mirë me fëmijët në shkollë, rreth 76.30% e qytetarëve e konsiderojnë si sjellje të papranueshme në rast se policia e komunikacionit kërkon nga vozitësi të holla për shkak të shkeljeve të rregullave në komunikacion nga ky i fundit, dhe rreth 76.20% e qytetarëve e konsiderojnë si sjellje të papranueshme kur një prokuror kërkon para në mënyrë që të mos realizojë hetime individë të caktuar.

Gjatë realizimit të këtij hulumtimi qytetarët janë pyetur edhe rreth shpeshësisë së rasteve kur ata u kanë dhënë zyrtarëve të caktuar publikë para ose dhurata shtesë në këmbim të marrjes së shërbimeve publike. Bazuar në të gjeturat faktike të këtij hulumtimi, rreth 32.50% e qytetarëve të anketuar kanë deklaruar t'u kenë dhënë para/dhurata shtesë mjekëve ose motrave medicinale për marrjen e shërbimeve shëndetësore, rreth 29.90% e tyre kanë deklaruar se këtë është dashur ta bëjnë me prokurorë, ndërkaq 28.30% e qytetarëve të anketuar kanë deklaruar se është dashur që t'u japin ryshfet zyrtarëve shtetërorë.

Përveç kësaj, qytetarët janë pyetur nëse ata disponojnë informacione për sjelljet korruptive të zyrtarëve të ndryshëm publikë. Sipas të dhënave të hulumtimit rezulton se rreth 31.40% e qytetarëve kanë deklaruar se shumë shpesh ndodhë që zyrtarët publikë t'u mundësojnë miqve apo të afërmeve të tyre të punësohen në sektorin publik, rreth 22.70% e qytetarëve kanë thënë se shumë shpesh ngjanë që zyrtarët publikë t'u mundësojnë

dhënien e kontratave ndërmarrjeve/kompanive që janë të afërta me vetë zyrtarët publikë, rreth 20.60% e qytetarëve kanë pohuar se ndodhë shumë shpesh ndodhë që zyrtarët publikë të pranojnë dhurata të çmueshme për ofrimin e shërbimeve publike, si dhe rreth 20.40% e qytetarëve kanë deklaruar që shumë shpesh ngjanë që zyrtarët publikë të pranojnë rryshfet në lidhjen e marrëveshjeve në prokurimin publik.

Të anketuarit e këtij hulumtimi gjithashtu janë pyetur rreth shpeshësisë së sjelljeve korruptive të përfaqësuesve të zgjedhur, përkatësisht politikanëve. Rreth 27.50% prej tyre kanë deklaruar se shumë shpesh ndodhë që politikanët të shfrytëzojnë mjetet apo pronën publike për nevoja personale apo familjare, rreth 26.10% e qytetarëve kanë deklaruar se shumë shpesh ndodhë që politikanët t'u mundësojnë kontrata të punës ndërmarrjeve që i kanë të afërta, rreth 21.40% e qytetarëve kanë deklaruar se shumë shpesh ndodhë që politikanët të marrin rryshfet përmes kontratave në prokurimin publik, rreth 17.80% e qytetarëve kanë deklaruar se shumë shpesh ndodhë që politikanët të marrin vendime madhore nën presionin e grupeve të ndryshme të interesit, rreth 26.80% e qytetarëve kanë deklaruar se ndodhë shumë shpesh që politikanët u mundësojnë bashkëpunëtorëve, miqve dhe familjarëve të tyre të avancohen më lehtë në pozita publike, dhe rreth 26.40% e qytetarëve kanë deklaruar se ndodhë shumë shpesh ndodhë që politikanët manipulojnë rezultatet e zgjedhjeve në Kosovë.

Qytetarët e Kosovës janë pyetur edhe për nivelin e korrupsionit në Kosovë në këto tre vitet e fundit—nëse është rritur, nëse ka mbetur i njëjtë apo është zvogëluar. Sipas të dhënave të hulumtimit, rreth 46.4% e qytetarëve mendojnë që niveli i korrupsionit në tre vitet e fundit është rritur në Kosovë, rreth 38.2% e qytetarëve kanë deklaruar se korrupsioni ka mbetur në po të njëjtin nivel, ndërsa vetëm 7.6% e qytetarëve kanë deklaruar se niveli i korrupsionit është zvogëluar. Gjithashtu, rreth 43.4% e të anketuarve kanë deklaruar se nuk ka pasur ndonjë përpjekje serioze për të zbatuar masa kundër korrupsionit në Kosovë nga ana e institucioneve publike.

Qytetarët e Kosovës janë pyetur gjithashtu nëse në 12 muajt e fundit kanë pasur ndonjë kontakt me zyrtarë të caktuar publikë për të kryer ndonjë shërbim, për të kërkuar informacion apo ndihmë, për të kërkuar dokumente apo kryerjen e ndonjë procedure tjetër administrative. Në shtesë të kësaj, ata janë pyetur edhe rreth cilësisë së shërbimeve që ata kanë marrë nga autoritetet përkatëse. Në pyetjen e parë, rreth 33.90% e qytetarëve të anketuar kanë deklaruar se kontaktet më të shpeshta gjatë 12 muajve të fundit i kanë pasur me zyrtarë komunalë, rreth 26.60% me policinë e Kosovës dhe rreth 6.70% e qytetarëve kanë deklaruar se gjatë kësaj periudhe kanë pasur kontakt me gjykatës. Sa i përket cilësisë së ofruar gjatë këtyre kontakteve, rreth 44.10% e qytetarëve i kanë cilësuar si shërbime shumë të mira që i kanë ofruar organizatat jo-qeveritare,

rreth 34% e qytetarëve kanë thënë policia e Kosovës dhe rreth 32.30% qytetarëve i kanë konsideruar si shërbime shumë të mira që i kanë ofruar deputetët e Kuvendit të Kosovës.

Më pas, qytetarëve të Kosovës u është kërkuar që të kujtojnë të gjitha kontaktet që i kanë pasur me zyrtarët e shtetit/publikë në 12 muajt e fundit, dhe nëse ka ndodhë që t'u japin dhuratë apo para. Nga përgjigjet e të anketuarve del se rreth 5.5% qytetarëve kanë deklaruar t'iu ketë ndodhur, rreth 84% kanë deklaruar se kjo nuk iu ka ndodhur asnjëherë, rreth 3.6% e qytetarëve nuk kanë qenë të sigurtë nëse iu kanë dhënë apo jo, ndërsa rreth 6.9% e të anketuarve kanë refuzuar të përgjigjen. Më keq qëndron puna tek çështja e ryshfetit, ku rreth 41.80% e qytetarëve kanë deklaruar se gjatë kësaj periudhe është dashur t'u japin ryshfet zyrtarëve të sistemit të shëndetësisë (mjekëve dhe motrave medicinale), rreth 14.50% e qytetarëve kanë deklaruar se është dashur t'u japin ryshfet zyrtarëve komunalë, ndërsa 14.80% e qytetarëve kanë deklaruar se është dashur t'u japin ryshfet zyrtarëve policorë.

Përveç kësaj, qytetarët që kanë dhënë ryshfet janë pyetur nëse e kanë raportuar këtë në institucione përkatëse. Paradoksalisht, vetëm 2.40% prej tyre kanë deklaruar se e kanë raportuar këtë në institucione përkatëse, ndërsa rreth 97.60% kanë deklaruar se këtë nuk e kanë bërë fare. Arsyet kryesore që nuk e kanë lajmëruar korrupsionin sipas 32.20% të qytetarëve është se ata kanë pasur dobi nga dhënia e ryshfetit, rreth 26.30% kanë deklaruar se nuk e kanë raportuar korrupsionin për shkak që institucionet nuk janë të interesuara për ta luftuar korrupsionin, ndërsa rreth 15.20% e qytetarëve kanë deklaruar se nuk e kanë raportuar korrupsionin për shkak të frikës nga pasojat e eventuale.

Po ashtu, gjatë këtij hulumtimi qytetarët e anketuar janë pyetur se nëse në të ardhmen ata dëshirojnë ta lajmërojnë një veprim korruptiv, tek cili autoritet do ta bënin një gjë të tillë. Sipas të gjeturave të hulumtimit, rreth 55.40% e qytetarëve kanë deklaruar se këtë do ta bënin në Policinë e Kosovës, rreth 24.50% e qytetarëve kanë deklaruar se këtë do ta bënin në Prokurori, ndërsa rreth 18.9% e qytetarëve kanë deklaruar se këtë do ta bënin në Agjencinë Kundër Korrupsion.

Gjatë realizimit të këtij hulumtimi Lëvizja FOL është interesuar njashtu për përvojat e qytetarëve në procesin e punësimit në sektorin publik dhe mundësitë e identifikimit të keqpërdorimeve gjatë këtij procesi. Sipas të dhënave të dala nga ky hulumtim, rreth 30.6% e të anketuarve kanë deklaruar se ata ose ndonjë anëtar i familjes së tyre ka konkurruar për vend pune në sektorin publik, ndërsa rreth 69.4% kanë deklaruar se asnjëherë nuk kanë konkurruar për ndonjë vend pune në sektorin publik. Prej atyre që kanë konkurruar vetëm 14.7% kanë deklaruar se e kanë fituar vendin e punës më meritë. Ndërsa, kur ata që nuk janë pranuar në punë janë pyetur për arsyet se mos punësimit të tyre, rreth 50.20% prej tyre kanë deklaruar se kjo ka ndodhur për shkak të lidhjeve nepotiste, dhe

rreth 17.70% e qytetarëve kanë deklaruar se kjo ka ndodhur sepse punën e ka fituar dikush që ka dhënë para.

Opinionet e qytetarëve mbi problemet kryesore me të cilat ballafaqohet Kosova

Në këtë hulumtim qytetarët janë pyetur për të identifikuar problemet kryesore me të cilat ballafaqohet Kosova. Sipas të gjeturave të hulumtimit, në renditje të përgjithshme rezulton se rreth 52.80% e qytetarëve të Kosovës problemin kryesor e konsiderojnë papunësinë, rreth 39.50% e qytetarëve e mendojnë korrupsionin, si dhe rreth 34% e qytetarëve e shohin performancën e dobët e Qeverisë së Kosovës si njërin nga problemet më kryesore në vend. Më specifikisht, qytetarët kanë renditur problemet si në vijim:

Problemi I: Papunësia

Papunësia rezulton të jetë problemi më i madh për qytetarët, ku rreth 52.8% prej tyre mendojnë që është problemi kryesor në vend, rreth 30% e shohin si problem të rëndësishëm të dytë, ndërsa rreth 17.2% mendojnë që është problem i rëndësishëm të tretë.

Problemi II: Korrupsioni

Si problem tjetër i radhës që qytetarët kanë identifikuar del të jetë niveli i lartë i korrupsionit dhe shtrirja e gjerë e tij në institucionet publike. Siç tregojnë të dhënat e hulumtimit, rreth 39.7% e qytetarëve mendojnë që është problemi kryesor në vend, rreth 38.1% vlerësojnë se është problem i dytësor, ndërsa rreth 22.2% e konsiderojnë se është problem i dorës së tretë.

Problemi III: Puna e Dobët e Qeverisë

Si problem tjetër i rëndësishëm rezulton të jetë puna e dobët e Qeverisë së Kosovës, ku 34.4% prej tyre mendojnë se është problemi më i rëndësishëm në vend, 25.6% e shohin si problem të dorës së dytë, dhe 40% e shohin si problem terciar.

Problemi IV: Puna e Dobët e Kuvendit

Ndërsa sa i përket Kuvendit të Kosovës qytetarët e Kosovës janë përgjigjur se 26.7% puna e Kuvendit është problemi më i rëndësishëm, rreth 40% mendojnë që është problem i rëndësishëm të dytësor, ndërsa 33.3% e qytetarëve mendojnë që puna e Kuvendit përben problem të rëndësishëm të tretësor.

Problemi V: Reformat në Administratën Publike

Kur janë pyetur për reformat në administratën publike, qytetarët janë përgjigjur se ky është problemi më i rëndësishëm në vlerë prej 25%, 33.3% janë përgjigjur që reformat në administratën publike janë problem sekondar, ndërsa 41.7% e tyre mendojnë që ky është problem terciar.

Problemi VI: Funkcionimi i Dobët i Sistemit Arsimor

Gjithashtu qytetarët e Kosovës janë pyetur për qëndrimet e tyre rreth funksionimit të dobët të sistemit arsimor në Kosovë dhe ata kanë shprehur këto qëndrime ku 24.5% mendojnë që ky është problemi më i rëndësishmi në Kosovë, rreth 22.6% prej tyre mendojnë që është problem i rëndësishëm të dytë ndërsa rreth 52.8% mendojnë që është problem i rëndësishëm të tretë në Kosovë.

Problemi VII: Funkcionimi i Dobët i Sistemit Gjyqësor

Sa i përket funksionimit të dobët të sistemit të drejtësisë në Kosovë, rreth 23.8% qytetarët e Kosovës mendojnë se është problemi kryesor, rreth 24.5% mendojnë që është problem dytësor ndërsa rreth 51.7% mendojnë që është problem i rëndësisë së tretë.

Problemi VIII: Mungesa e Zhvillimit Ekonomik

Sa i përket zhvillimit ekonomik rreth 20.2% mendojnë që është problem kryesor në Kosovë, rreth 27.8% mendojnë që është problem për ka rëndësia dytësore ndërsa rreth 52% mendojnë që është problem i tretë për kah rëndësia.

Problemi IX: Kriminaliteti dhe Pasiguria

Ndërsa sa i përket kriminalitetit dhe pasigurisë në Kosovë rreth 18.8% e qytetarëve mendojnë është problemi kryesor në vend, rreth 29.2% mendojnë që është problem i rëndësisë së dytë ndërsa 52.1% e qytetarëve mendojnë që ky është një problem i rëndësisë së tretë në vend.

Problemi X: Varfëria

Për sa i përket varfërisë në vend rreth 14.5% e qytetarëve mendojnë që është problemi kryesor që i preokupon ata, 46% prej tyre mendojnë që është problem i rëndësisë së dytë ndërsa 39.5% mendojnë që është problem i rëndësisë së tretë.

Problemi XI: Funkcionimi i Dobët i Sistemit Shëndetësor

Kurse kur janë pyetur rreth funksionimit të dobët të sistemit të shëndetësisë rreth 12.7% e tyre mendojnë që ky është një problem kryesor në Kosovë, rreth 32.8% prej tyre mendojnë që është problem i rëndësisë së dytë në Kosovë ndërsa rreth 49.1% mendojnë që është problem i rëndësisë së tretë në Kosovë.

Problemi XII: Gjendja e Keqe Infrastrukturore

Sa i përket gjendjes së infrastrukturës rreth 11.8% mendojnë që është problem parësor, rreth 27.6% mendojnë që është problem sekondar ndërsa 60.5% mendojnë që është problem i rëndësisë së tretë.

Problemi XIII: Problemet Mjedisore

Sa i përket problemeve mjedisore në vend vetëm 5.3% e qytetarëve mendojnë që ky është problem kryesor në vend, rreth 10.5% prej tyre mendojnë që është problem i rëndësisë së dytë ndërsa rreth 84.2% mendojnë që është problem i rëndësisë së tretë në Kosovë.

Problemi XIV: Mos-liberalizimi i Vizave

Sa i përket procesit të liberalizimit të vizave në Kosovë vetëm 8.4% e qytetarëve mendojnë që është problemi më kryesor i vendit, rreth 8.3% mendojnë që është problem i rëndësisë së dytë ndërsa rreth 83.3% mendojnë që është problem i rëndësisë së tretë për Kosovën.

Opinionet e qytetarëve rreth pranisë së korrupsionit në institucionet/ sektorët publik

Në këtë hulumtim, qytetarët janë pyetur edhe për praninë e korrupsionit në institucione apo sektor publik.

Institucioni I: Qeveria e Kosovës

Sipas të gjeturave të hulumtimit, rezulton se rreth 40.3% e qytetarëve të Kosovës mendojnë që korrupsioni është shumë shpesh i pranishëm në Qeverinë e Kosovës, rreth 43.1% mendojnë që është shpesh i pranishëm, ndonjëherë mendojnë 13.7%, rrallë 1.4% dhe asnjëherë vetëm 0.7%.

Institucioni II: Kuvendi i Kosovës

Në rastin e Kuvendit të Kosovës, rreth 23.6% e qytetarëve të anketuar mendojnë që korrupsioni është shumë shpesh i pranishëm në këtë institucion, 34.3% konsiderojnë se është shpesh i pranishëm, ndonjëherë konsiderojnë 26%, rrallë 9.9% dhe vetëm 1.6% konsiderojnë asnjëherë.

Institucioni III: Sistemi Gjyqësor

Sa i përket sistemit gjyqësor në Kosovë, 26.1% e qytetarëve të anketuar mendojnë se korrupsioni është shumë shpesh i pranishëm në këtë sistem, 38% mendojnë që është shpesh i pranishëm, 20.1% mendojnë që ndonjëherë, rrallë mendojnë vetëm 8%, ndërsa asnjëherë vetëm 1.3%.

Institucioni IV: Komunitat

Në pyetjen për pushtetin lokal, 25.9% e qytetarëve mendojnë se korrupsioni është shumë shpesh i pranishëm nëpër Komuna, 37.9% e tyre mendojnë se është shpesh i pranishëm, 23.5% e qytetarëve mendojnë se ndonjëherë korrupsioni është i pranishëm nëpër Komuna, rrallë mendojnë vetëm 5.9% e tyre, ndërsa asnjëherë vetëm 3.7%.

Institucioni V: Sistemi Prokurorial

Sa i përket prokurorisë rreth 23.9% e qytetarëve mendojnë se korrupsioni është shumë shpesh i pranishëm, rreth 35.8% prej tyre mendojnë që korrupsioni është shpesh i pranishëm në prokuroritë e Kosovës, rreth 20% e tyre mendojnë që ndonjëherë korrupsioni është i pranishëm në prokurori, rrallë mendojnë rreth 8.8% ndërsa asnjëherë vetëm 2.4% e qytetarëve.

Institucioni VI: Policia e Kosovës

Për Policinë e Kosovës rreth 8.3% e qytetarëve mendojnë që korrupsioni është shume shpesh i pranishëm në këtë institucion. Rreth 22.9% mendojnë që është shpesh i pranishëm, ndonjëherë mendojnë rreth 26.4% e qytetarëve, rrallë rreth 21.7% ndërsa 13.3% e qytetarëve të Kosovës mendojnë që asnjëherë nuk është i pranishëm korrupsioni në këtë institucion.

Institucioni VII: Forca e Sigurisë së Kosovës

Sa i përket Forcës së Sigurisë së Kosovës, vetëm 4.8% e qytetarëve mendojnë që korrupsioni është shumë shpesh i pranishëm në këtë institucion, rreth 8.7% e tyre mendojnë që është shpesh i pranishëm, ndonjëherë rreth 14.2%, rrallë 16.6% ndërsa asnjëherë korrupsioni nuk është i pranishëm në këtë institucion mendojnë rreth 43.2% e qytetarëve të Kosovës.

Institucioni VIII:

Administrata Tatimore e Kosovës

Sipas qytetarëve të Kosovës korrupsioni është shumë shpesh i pranishëm në Administratën Tatimore të Kosovës në vlerë prej 11.2%. Shpesh mendojnë rreth 22.9% e qytetarëve të Kosovës, se korrupsioni ndonjëherë është i pranishëm mendojnë rreth 32.6% të qytetarëve, rrallë mendojnë 11.5% ndërsa që asnjëherë korrupsioni nuk është i pranishëm në ATK mendojnë vetëm 5.3% e të anketuarve.

Institucioni IX: Doganat e Kosovës

Tek Doganat e Kosovës rreth 16.1% e qytetarëve të Kosovës mendojnë që korrupsioni është shume shpesh i pranishëm, rreth 33.7% mendojnë që korrupsioni është shpesh i pranishëm, ndonjëherë mendojnë rreth 26.8% e qytetarëve të Kosovës, rrallë vetëm 7.4% ndërsa që asnjëherë korrupsioni nuk është i pranishëm në këtë institucion mendojnë vetëm 1.8% e qytetarëve.

Institucioni X: Ndërmarrjet Publike

Sa i përket qëndrimeve të qytetarëve të Kosovës rreth korrupsionit në Ndërmarrje Publike rreth 15.3% e tyre mendojnë që korrupsioni është shumë shpesh i pranishëm në këto ndërmarrje. Rreth 31.1% mendojnë që korrupsioni është shpesh i pranishëm, rreth 29.5% e tyre mendojnë se ndonjëherë korrupsioni është i pranishëm, rrallë mendojnë 7.3% ndërsa që asnjëherë vetëm 2% e të anketuarve.

Institucioni XI: Sistemi Shëndetësor

Gjithashtu qytetarët janë anketuar edhe rreth nivelit të pranisë së korrupsionit në sektorin shëndetësor, përkatësisht nëpër spitale publike. Rreth 18.1% e të anketuarve kanë deklaruar se korrupsioni në këtë sektor është shumë shpesh i pranishëm. Rreth 34.4% mendojnë që korrupsioni është shpesh i pranishëm në këtë sektor, ndonjëherë mendojnë rreth 30.1%, rrallë rreth 7.6% ndërsa asnjëherë vetëm 3.4% e qytetarëve.

Institucioni XII: Sistemi Arsimor

Qytetarët janë pyetur edhe për nivelin e korrupsionit në sistemin arsimor, përkatësisht nivelin e korrupsionit në shkolla publike. Rreth 10.5% e qytetarëve të Kosovës kanë deklaruar se korrupsioni është shume shpesh i shtrirë në shkolla publike, rreth 21.8% mendojnë që korrupsioni është shpesh i pranishëm, ndërsa ndonjëherë mendojnë rreth 31.2% e të anketuarve, se korrupsioni është rrallë i pranishëm në shkolla publike mendojnë rreth 17.1% ndërsa që asnjëherë korrupsioni nuk është i pranishëm në shkolla publike mendojnë vetëm 7.9% e qytetarëve të Kosovës.

Institucioni XIII: Universitetet Publike

Gjithashtu qytetarët janë pyetur edhe për nivelin e korrupsionit në universitetet publike. Në këtë kontekst rreth 13.6% e qytetarëve kanë deklaruar se korrupsioni është shumë shpesh i pranishëm në universitetet publike, rreth 24.1% mendojnë që korrupsioni është shpesh i pranishëm, ndonjëherë mendojnë rreth 30.9% e të anketuarve, që korrupsioni është rrallë i pranishëm në universitete publike mendojnë vetëm 14.6% e qytetarëve ndërsa që korrupsioni asnjëherë nuk është i pranishëm në këto institucione mendojnë vetëm 6.7% e të anketuarve.

Institucioni XIV: Sektori Privat

Sa i përket ndërmarrjeve private rreth 8% e

qytetarëve konsiderojnë së korrupsioni është shume shpesh i pranishëm, rreth 13.4% e qytetarëve mendojnë se korrupsioni është shpesh i pranishëm në ndërmarrjet private, ndërsa rreth 37.5% mendojnë që ndonjëherë korrupsioni është i pranishëm në ndërmarrjet private, rrallë mendojnë rreth 15.5% kurse 6.3% e të anketuarve mendojnë që asnjëherë korrupsioni nuk është i pranishëm në ndërmarrjet private.

Institucioni XV: Partitë Politike

Në kontekst të nivelit të korrupsionit tek partitë politike, rreth 27.9% e qytetarëve mendojnë që korrupsioni është shumë shpesh i pranishëm. Rreth 36.3% e qytetarëve mendojnë që korrupsioni është shpesh i pranishëm në partitë politike, ndonjëherë mendojnë rreth 23.9%, rrallë rreth 6.1%

ndërsa që korrupsioni asnjëherë nuk është i pranishëm në partitë politike mendojnë vetëm 0.4% e qytetarëve të Kosovës.

Institucioni XVI:

Organizatat Jo-Qeveritare

Qytetarët e Kosovës janë pyetur edhe rreth qëndrimeve të tyre për nivelin e korrupsionit në sektorin e Organizatave Jo-qeveritare. Në këtë kontekst rreth 7.6% e qytetarëve janë përgjigjur se besojnë që korrupsioni është shumë i pranishëm në këtë sektor, rreth 10.9% kanë theksuar se është nivel i shpeshtë, 38.8% mendojnë se ndonjëherë korrupsioni është i pranishëm në këtë sektor, rreth 20.6% mendojnë që niveli është shumë i rrallë ndërsa 7.1% mendojnë se asnjëherë në këtë sektor nuk është i pranishëm korrupsioni.

Opinionet e qytetarëve rreth sjelljeve të ndryshme korruptive

Përveç aspekteve që kanë të bëjnë me besueshmërinë e qytetarëve në institucionet e vendit, qytetarëve të anketuar iu është paraqitur një listë e sjelljeve korruptive, me të cilën është shikuar nëse veprimet korruptive janë të pranueshme për qytetarët.

Në pyetjen se kur mjeku që kërkon para/dhuratë në shkëmbim të mjekimit/trajtimin më të mirë, rreth 4.6% e respondentëve janë përgjigjur që kjo sjellje është gjithmonë e pranueshme për ta, rreth 12% prej tyre kanë deklaruar se kjo sjellje është kryesisht e pranueshme, 10% e të anketuarve kanë thënë se ndonjëherë kjo sjellje është e pranueshme, ndërsa rreth 70.2% e qytetarëve kanë deklaruar se kjo sjellje nuk është e pranueshme.

Në pyetjen tjetër, se a duhet një zyrtar publik të kryejë edhe ndonjë punë shtesë për t'i ngritur të ardhurat e tij/saj, rreth 9.3% e respondentëve janë përgjigjur se kjo është gjithmonë e pranueshme, rreth 21.9% kanë deklaruar se është kryesisht e pranueshme, ndonjëherë e pranueshme kanë deklaruar rreth 12% e qytetarëve, ndërsa që 53.9% e të anketuarve kanë thënë se një veprim i tillë nuk është i pranueshëm.

Ndërsa në pyetjen nëse një person punësohet përmes lidhjeve familjare apo përmes shoqërisë, rreth 3.3% e të anketuarve kanë theksuar se kjo është gjithmonë e pranueshme për ta, rreth 11.3% kanë deklaruar se kjo është kryesisht e pranueshme, ndonjëherë e pranueshme kanë deklaruar rreth 12.3%, ndërsa 69.9% e qytetarëve të anketuar kanë deklaruar se një sjellje e tillë nuk është e pranueshme.

Në pyetjen tjetër, nëse duhet që polici i komunikacionit të kërkojë të holla në vend të shqiptimit të gjobës, vetëm 1.1% e respondentëve janë deklaruar se kjo sjellje është gjithmonë e pranueshme, si sjellje kryesisht të pranueshme e kanë cilësuar 9.1% kanë deklaruar se një sjellje e tillë ndonjëherë është e pranueshme, 9.1% e kanë cilësuar si sjellje që nuk është e pranueshme janë deklaruar 76.3% e qytetarëve.

Në rastet kur një arsimtar ose profesor kërkon para/dhuratë për t'u sjellë më mirë me fëmijët në shkollë rreth 1.3% e të anketuarve kanë deklaruar se kjo sjellje është gjithmonë e pranueshme, si kryesisht e pranueshme janë deklaruar rreth 7.4% e respondentëve, si ndonjëherë e pranueshme janë deklaruar rreth 9.8% e qytetarëve, ndërsa si sjellje totalisht e papranueshme janë deklaruar rreth 78% e të anketuarve.

Ndërsa kur arsimtari ose profesori i ofrohen para/dhuratë për t'u sjellë më mirë me fëmijët në shkollë rreth 2% e qytetarëve mendojnë që kjo sjellje është gjithmonë e pranueshme për ta, rreth 8.7% e të anketuarve mendojnë që kjo sjellje është kryesisht e pranueshme, si ndonjëherë e pranueshme mendojnë 9.7% e qytetarëve, ndërsa si sjellje që nuk është e pranueshme mendojnë rreth 75.7% e qytetarëve të Kosovës.

Në pyetjen nëse qytetarët duhet t'u paguajnë të holla zyrtarëve publikë për t'i përshpejtuar procedurat administrative, rreth 1.8% e qytetarëve mendojnë që kjo sjelle është gjithmonë e pranueshme, rreth 10.4% mendojnë që kjo sjellje është kryesisht e pranueshme, 12.2% mendojnë se ndonjëherë kjo sjellje është e pranueshme, ndërsa 72.3% e respondentëve mendojnë që kjo sjellje nuk është e pranueshme.

Ndërsa në rastet kur një zyrtar publik pranon dhurata nga një firmë private e kontraktuar nga institucionet publike rreth 2.6% e qytetarëve mendojnë që kjo sjellje është gjithmonë e pranueshme, si kryesisht të pranueshme mendojnë rreth 10.8% e qytetarëve, ndonjëherë e pranueshme kanë deklaruar 13.8%, ndërsa 68.3% e qytetarëve mendojnë që një sjellje e tillë nuk është e pranueshme.

Qytetarët në këtë hulumtim janë pyetur edhe për sjelljet e zyrtarëve të institucioneve të sistemit të drejtësisë. Në pyetjen se kur prokurori kërkon para/dhuratë në mënyrë që të mos realizojë hetime ndaj individëve të caktuar, vetëm 0.6% e qytetarëve e shohin si sjellje gjithmonë të pranueshme, 9.3% e shohin si kryesisht të pranueshme, rreth 9.5% e të anketuarve e vlerësojnë si ndonjëherë të pranueshme, ndërsa rreth 76.2% e qytetarëve të anketuar këtë lloj të sjelljes e shohin si të pa pranueshme.

Ndërsa në pyetjen se kur prokurorit i ofrohen para për favore të caktuara, vetëm 1.5% e qytetarëve kanë deklaruar se kjo sjellje është gjithmonë e pranueshme, 9.5% kanë deklaruar se kjo sjellje është kryesisht e pranueshme, 10.4% si ndonjëherë të pranueshme, ndërsa 74% e të anketuarve kanë deklaruar se kjo sjellje nuk është e pranueshme.

Sa i përket sistemit gjyqësor, kur qytetarët janë pyetur se kur gjykatësi kërkon para në mënyrë që të mos i dënojë individë të caktuar vetëm 0.9% e kanë konsideruar këtë si sjellje si gjithmonë të pranueshme, si kryesisht të pranueshme e kanë konsideruar rreth 8.5%, rreth 11.6% kanë deklaruar se kjo sjellje është ndonjëherë e pranueshme, kurse 74.1% e respondentëve të anketuar kanë deklaruar se kjo sjellje nuk është aspak e pranueshme.

Kurse në pyetjen se kur gjykatësve u ofrohen para në mënyrë që mos t'i dënojë individë të caktuar vetëm rreth 1.6% e respondentëve kanë deklaruar se kjo sjelle është gjithmonë e pranueshme, si kryesisht të pranueshme e kanë konsideruar rreth 9.2%, rreth 10.1% mendojnë që kjo sjellje është ndonjëherë e pranueshme, ndërsa 73.7% e qytetarëve mendojnë që kjo sjellje nuk është e pranueshme.

Sipas mendimit tuaj, cilat janë 3 problemet më të rëndësishme me të cilat ballafaqohet sot Kosova?

Kuvendi i Kosovës	23.6%	34.3%	26%	9.9%	1.6%
Qeveria	40.3%	43.1%	13.7%	1.4%	0.7%
Komuna	25.9%	37.9%	5.9%	23.5%	3.7%
Gjykata	26.1%	38%	20.1%	8%	1.3%
Prokurori	23.9%	35.8%	20%	8.8%	2.4%
Polici	8.3%	22.9%	26.4%	21.7%	13.3%
FSK	4.8%	8.7%	14.2%	16.6%	43.2%
Administratë tatimore	11.2%	22.9%	32.6%	11.5%	5.3%
Dogana	16.1%	33.7%	26.8%	7.4%	1.8%
Ndërmarrje publike	15.3%	31.1%	29.5%	7.3%	2%
Spitale publike	18.1%	34.4%	7.6%	30.1%	3.4%
Shkolla publike	10.5%	31.2%	21.8%	17.1%	7.9%
Universitet publike	13.6%	24.1%	30.9%	14.6%	6.7%
Ndërmarrje private	8%	13.4%	37.5%	15.5%	6.3%
Parti politike	27.9%	36.3%	23.9%	6.1%	0.4%
Organizata jo-qeveritare	7.6%	10.9%	38.8%	20.6%	7.1%

SHUMË SHPESH

SHPESH

NDONJËHERË

RRALLË

ASNJËHERË

Sa janë të shpeshtë tek ne mënyrat vijuese të sjelljes në mesin e zyrtarëve të shtetit (që janë të punësuar në sektorin publik)?

Zyrtarët publik që u mundësojnë miqve apo të afërmeve të punësohen në sektorin publik	31.4%	42.4%	20.3%	2.9%	0.3%
Zyrtarët publik u mundësojnë dhënien e kontratave ndërmarrjeve që i kanë të afërta	22.7%	45.6%	23.1%	4.3%	0.4%
Zyrtarët publik të pranojnë dhurata të çmueshme për ofrimin e shërbimeve publike	20.6%	42.2%	27.8%	4.2%	0.6%
Pranimi i rryshfetit nga ana e zyrtarëve publik në lidhjen e marrëveshjeve në prokurimin publik	20.4%	43%	24.5%	5.5%	1%

SHUMË SHPESH

SHPESH

NDONJËHERË

RRALLË

ASNJËHERË

Përvojat e qytetarëve në dhënien e ryshfeti për marrjen e shërbimeve publike

Qytetarët e anketuar janë pyetur rreth përvojës së tyre në marrjen e shërbimeve publike. Më specifikisht, qytetarët janë pyetur nëse për marrjen e shërbimeve publike është dashur të japin para apo dhurata shtesë, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë, qoftë në mënyrë të tërthortë—përmes ndonjë personi tjetër.

Sipas të dhënave të hulumtimit, kur qytetarët janë pyetur se sa shpesh është dashur të japin para ose dhurata shtesë mjekëve ose motrave medicinale për të marrë shërbime mjekësore, rreth 10.6% e të anketuarve janë përgjigjur se kjo ka ndodhur shumë shpesh, rreth 32.5% kanë deklaruar se kjo ndodhur shpesh, ndonjëherë kanë deklaruar rreth 36.7%, rrallë kanë deklaruar rreth 7.4%, ndërsa asnjëherë nuk ka ndodhur kanë deklaruar vetëm 9.6% e qytetarëve të anketuar.

Në pyetjen se sa shpesh qytetarët kanë paguar të holla/dhurata arsimtarëve/profesorëve (e.g. për dhënien e provimeve), rreth 4.6% e respondentëve kanë deklaruar se kjo ndodhë shumë shpesh, rreth 16.4% kanë deklaruar se kjo ndodh shpesh, 33.4% kanë deklaruar se kjo ndodh ndonjëherë, rreth 20.3% kanë deklaruar se kjo ndodhë rrallë, kurse që asnjëherë nuk ndodh kanë deklaruar rreth 17.5% e qytetarëve.

Sa i përket asaj se sa shpesh qytetarët u kanë dhënë para zyrtarëve shtetërorë/publikë, rreth 5.3% e tyre kanë deklaruar se kjo ka ndodhur shumë shpesh, rreth 28.3% kanë deklaruar se kjo ka ndodhur shpesh, ndonjëherë kanë deklaruar rreth 35.7% e të anketuarve, rreth 9.4% kanë deklaruar se kjo ndodhur rrallë dhe rreth 4.6% kanë deklaruar se kjo nuk ka ndodhur asnjëherë.

Në pyetjen tjetër, se sa shpesh qytetarët kanë paguar policët për të evituar shqiptimin e dënimeve në komunikacion, rreth 4.4% prej tyre kanë deklaruar se kjo ka ndodhur shumë shpesh, rreth 20.5% kanë deklaruar se kjo ka ndodhur shpesh, 36.9% kanë thënë ndonjëherë, rrallë herë janë përgjigjur rreth 11.6%, ndërsa rreth 16.2% kanë theksuar se kjo nuk iu ka ndodhur asnjëherë.

Përveç kësaj, qytetarët janë pyetur nëse kanë paguar ryshfet apo jo me rastin e marrjes së patentë shoferëve/dhënies së testit të vozitjes. Sipas të dhënave të këtij hulumtimi, rreth 17.7% e respondentëve janë përgjigjur se kjo iu ka ndodhur shumë shpesh, 26.3% e qytetarëve kanë deklaruar që iu ka ndodhur shpesh, rreth 33.5% kanë deklaruar ndonjëherë, rrallë janë deklaruar rreth 7.5%, ndërsa asnjëherë kanë deklaruar vetëm 6.2% e të anketuarve.

Qytetarët janë pyetur njëkohësisht edhe rreth përvojës së tyre me zyrtarët komunalë. Bazuar në të gjeturat e hulumtimit, 4.7% e qytetarëve kanë deklaruar të kenë paguar shumë shpesh zyrtarët komunalë në shkëmbim të marrjes së shërbimeve të caktuara, rreth 23.5% e të

anketuarve kanë deklaruar t'iu ketë ndodhur shpesh, 41.7% ndonjëherë, 8.6% rrallëherë, ndërsa 13.6% kanë deklaruar t'iu ketë ndodhur asnjëherë.

Gjithashtu, qytetarët e anketuar janë pyetur nëse iu ka ndodhur që t'u japin ryshfet zyrtarëve të sistemit të drejtësisë, përkatësisht gjykatësve. Bazuar në të dhënat e hulumtimit, rezulton se rreth 6.5% e qytetarëve kanë deklaruar se kjo iu ka ndodhur shumë shpesh, rreth 32% kanë deklaruar se kjo iu ka ndodhur shpesh, që ndonjëherë iu ka ndodhur të japin ryshfet gjykatësve kanë deklaruar rreth 31% e qytetarëve, rrallë kanë deklaruar rreth 9.5% e respondentëve, ndërsa që nuk iu ka ndodhur asnjëherë të paguajnë ryshfet kanë deklaruar rreth 6.4% e qytetarëve.

Ndërsa sa i përket dhënies se ryshfetit për prokurorë rreth 5.1% e qytetarëve kanë deklaruar se kjo iu ka ndodhur shume shpesh, rreth 29.9% kanë deklaruar se kjo ka ndodhur shpesh, ndonjëherë rreth 32.9%, rrallë rreth 9.3% dhe vetëm 6.6% e të anketuarve kanë theksuar se kjo nuk iu ka ndodhur asnjëherë.

Sa i përket zyrtarëve tatimorë rreth 4.9% e qytetarëve kanë deklaruar se iu ka ndodhur shumë shpesh të iu japin ryshfet, shpesh kanë deklaruar rreth 21.1%, rreth 41.8% kanë deklaruar se kjo iu ka ndodhur ndonjëherë, rrallë kanë deklaruar rreth 9% dhe vetëm 8.5% kanë deklaruar që asnjëherë nuk iu ka ndodhur që të japin ryshfet një zyrtari tatimor.

Në kontekst të doganave, përkatësisht zyrtarëve doganorë, rreth 7.8% kanë deklaruar se iu ka ndodhur shumë shpesh t'u paguajnë ryshfet, rreth 27.9% kanë deklaruar se iu ka ndodhur shpesh, ndonjëherë kanë deklaruar rreth 33.9% të qytetarëve, rreth 8.2% kanë deklaruar se kjo iu ka ndodhur rrallë, kurse vetëm 5.5% kanë deklaruar se kjo nuk iu ka ndodhur asnjëherë.

Ndërsa në pyetjen se sa shpesh iu ka ndodhur qytetarëve të Kosovës të japin ryshfet për procedurat e lejeve të ndërtimit, rreth 5.2% kanë deklaruar se kjo iu ka ndodhur shumë shpesh, rreth 26.9% kanë deklaruar se kjo iu ka ndodhur shpesh, që ndonjëherë kanë dhënë ryshfet për leje ndërtimore kanë deklaruar rreth 40.5% e qytetarëve, rrallë kanë deklaruar rreth 7.8%, ndërkaq vetëm 7.3% kanë deklaruar që asnjëherë nuk iu kanë dhënë ryshfet për marrjen e lejeve ndërtimore.

Njohuritë e qytetarëve rreth mënyrave vijuese të sjelljeve në mesin e zyrtarëve publik

Qytetarët e Kosovës të anketuar në këtë hulumtim janë pyetur se sa janë të shpeshta sjelljet e zyrtarëve publikë që u mundësojnë miqve apo të afërmeve të tyre të punësohen në sektorin publik. Sipas të dhënave të hulumtimit, del se rreth 31.4% e qytetarëve deklarojnë që kjo sjellje është shumë e shpeshtë në mesin e zyrtarëve publikë, se kjo sjellje ndodhë shpesh mendojnë 42.4% e qytetarëve, ndonjëherë 20.3%, rrallë vetëm 2.9%, ndërsa si sjellje që asnjëherë nuk iu ka ndodhur kanë deklaruar vetëm 0.3% e qytetarëve të Kosovës.

Në pyetjen e radhës, sesa zyrtarët publikë u mundësojnë dhënien e kontratave ndërmarrjeve që i kanë të afërta, rreth 22.7% e qytetarëve të Kosovës kanë deklaruar se një gjë e tillë ndodhë shumë shpesh, 45.6% e qytetarëve kanë deklaruar se kjo sjellje është e shpeshtë, se ndonjëherë zyrtarët publikë u mundësojnë kontrata publike ndërmarrjeve të afërta me ta mendojnë rreth 23.1% e të anketuarve, që kjo ndodhë rrallë kanë deklaruar 4.3%, ndërsa që asnjëherë nuk ka ndodhur kanë deklaruar vetëm 0.4% e respondentëve.

Se sa shpesh ndodhë që zyrtarët publik të pranojnë dhurata të çmueshme për ofrimin e shërbimeve publike rreth 20.6% e të anketuarve janë përgjigjur se kjo ka ndodhur shumë shpesh, se kjo ndodhë shpesh janë deklaruar rreth 42.2% e qytetarëve, ndonjëherë rreth 27.8%, rrallë janë deklaruar 4.2% dhe vetëm 0.6% e qytetarëve të anketuar kanë deklaruar se kjo nuk ka ndodhur asnjëherë.

Për pranimin e rryshfetit nga ana e zyrtarëve publikë në lidhjen e marrëveshjeve në prokurimin publik rreth 20.4% e qytetarëve deklarojnë që kjo sjellje është shume e shpeshtë, rreth 43% prej tyre mendojnë që kjo ndodhë shpesh, ndonjëherë kanë deklaruar rreth 24.5% e të anketuarve, rrallë kanë deklaruar rreth 5.5%, ndërkaq sisjellje që asnjëherë nuk ka ndodhur kanë deklaruar vetëm 1% e të anketuarve.

42.2%

kanë thënë se se kjo ndodhë shpesh në pyetjen "Sa shpesh ndodhë që zyrtarët publik të pranojnë dhurata të çmueshme për ofrimin e shërbimeve publike"

A mendoni se në 3 vitet e fundit, autoritet publike vendore kanë implementuar politika apo masa efektive kundër korrupsionit?

Po, disa masa janë implementuar dhe disa rezultate janë arritur

7.2%



Po, disa masa janë implementuar por rezultate kanë qenë të vogla

33.2%



Jo, nuk ka pasë ndonjë përpjekje të vërtetë për të implementuar masa kundër korrupsionit

43.4%



Njohuritë e qytetarëve rreth mënyrave vijuese të sjelljeve në mesin e politikanëve

Të anketuarit janë pyetur njëkohësisht se sa shpesh të zgjedhurit që mbajnë funksione publike shfrytëzojnë mjetet apo pronën publike për nevoja personale apo familjare. Bazuar në të gjeturat faktike të këtij hulumtimi, rezulton se rreth 27.5% e qytetarëve kanë deklaruar se kjo sjellje është shumë e shpeshtë në mesin e tyre, rreth 42.6% mendojnë që kjo sjellje është e shpeshtë në mesin e tyre, si sjellje që ndonjëherë ndodhë kanë deklaruar 21.6%, rrallë kanë deklaruar 3.2%, ndërsa vetëm 0.7% e qytetarëve kanë deklaruar se kjo sjellje nuk ndodhë asnjëherë në mesin e politikanëve të Kosovës.

Se sa shpesh u mundësojnë politikanët kosovarë kontrata të punës ndërmarrjeve që i kanë të afërta rreth 26.1% e qytetarëve kanë deklaruar se kjo ndodh shumë shpesh, rreth 46.1% kanë deklaruar se kjo sjellje ndodhë shpesh, ndonjëherë kanë deklaruar rreth 19.9% e respondentëve, si sjellje që ndodhë rrallë në mesin e politikanëve kanë deklaruar rreth 2.5%, kurse vetëm 0.2% e të anketuarve kanë deklaruar se kjo sjellje nuk ndodhë asnjëherë në mesin e politikanëve kosovarë.

Se a marrin ryshfet politikanët kosovarë përmes kontratave të prokurimit publik rreth 21.4% e qytetarëve të anketuar kanë deklaruar se kjo sjellje ndodhë shumë shpesh, rreth 44.7% kanë deklaruar se kjo sjellje ndodhë shpesh, si sjellje që ndodhë ndonjëherë kanë deklaruar rreth 23.2%, si sjellje e rrallë kanë deklaruar rreth 2.2%, ndërsa vetëm 0.6% e qytetarëve kanë deklaruar se kjo sjellje nuk ndodhë asnjëherë në mesin e politikanëve kosovarë.


Në shtesë të kësaj, qytetarët e anketuar janë pyetur nëse politikanët kosovarë marrin vendime nën presionin e grupeve të ndryshme të interesit. Sipas të gjeturave të hulumtimit, rreth 17.8% e të anketuarve kanë deklaruar se kjo sjellje është shumë e shpeshtë, si sjellje të shpeshtë kanë deklaruar rreth 45% e të anketuarve, si sjellje që ndodhë ndonjëherë kanë deklaruar 23.3% e qytetarëve, rrallë kanë deklaruar rreth 4.1%, kurse si sjellje që sipas qytetarëve nuk ka ndodhur asnjëherë kanë deklaruar vetëm 0.8%.

Se sa politikanët kosovarë u mundësojnë bashkëpunëtorëve, miqve dhe familjarëve të tyre të avancohen më lehtë në pozita publike, rreth 26.8% e qytetarëve mendojnë se një gjë e tillë shumë shpesh ngjanë; rreth 43.9% e të anketuarve kanë deklaruar se kjo sjellje është e shpeshtë, si sjellje që ndodhë ndonjëherë kanë deklaruar rreth 19.8% e qytetarëve, si sjellje e rrallë kanë deklaruar rreth 3.7%, ndërsa vetëm 0.1% e qytetarëve kanë deklaruar se kjo sjellje nuk ka ndodhur asnjëherë nga politikanët kosovarë.

Po ashtu, qytetarët e Kosovës janë pyetur edhe për atë se sa shpesh ndodhë që politikanët kosovarë të bëjnë manipulimin e rezultateve

zgjedhore në Kosovë. Sipas të dhënave të hulumtimit, rreth 26.4% e qytetarëve të anketuar mendojnë se një sjellje e tillë ndodhë shumë shpesh, rreth 42.4% e qytetarëve mendojnë që shpesh, si sjellje që ndodhë ndonjëherë kanë deklaruar rreth 19.8% e qytetarëve, rrallë kanë deklaruar 3.9%, kurse vetëm 0.4% e qytetarëve kanë deklaruar se kjo sjellje nuk ka ndodhur asnjëherë në mesin e politikanëve kosovarë.

Sipas mendimit tuaj, sa shpesh është i pranishëm korrupsioni në institucionet/sectorët vijues?



Perceptimi i qytetarëve të Kosovës rreth nivelit të korrupsionit në Kosovë

Qytetarët e Kosovës janë pyetur edhe për nivelin e korrupsionit në Kosovë në këto tre vitet e fundit, se a është rritur ky nivel, a ka mbetur i njëjtë, apo është zvogëluar. Sipas të gjeturave të hulumtimit, rreth 46.4% e qytetarëve të Kosovës mendojnë që niveli i korrupsionit në Kosovë në tre vitet e fundit është rritur, rreth 38.2% e qytetarëve kanë deklaruar se korrupsioni ka mbetur në po të njëjtin nivel, ndërsa vetëm 7.6% e qytetarëve kanë deklaruar se niveli i korrupsionit është zvogëluar në tre vitet e fundit.

Gjithashtu, qytetarët e Kosovës janë pyetur nëse institucionet publike kanë ndërmarrë masa e politika adekuate në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit. Bazuar në përgjigjet e respondentëve, rreth 7.2% e qytetarëve kanë deklaruar se disa masa janë zbatuar dhe disa rezultate janë arritur, rreth 33.2% e qytetarëve kanë deklaruar se disa masa janë zbatuar por që rezultatet kanë qenë të vogla, rreth 43.4% e të anketuarve kanë deklaruar se nuk ka pasur ndonjë përpjekje të vërtetë për të zbatuar masa kundër korrupsion në Kosovë nga ana e institucioneve publike.

41.7%

e qytetarëve kanë deklaruar të kenë paguar ndonjëherë zyrtarët komunalë në shkëmbim të marrjes së shërbimeve të caktuara.

Duke u bazuar në përvojën tuaj të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, sa shpesh do t'i duhet qytetari të japë rryshfet në sektorët vijues?

Mjekëve/motrave medicinale	10.6%	32.5%	36.7%	7.4%	9.6%
Arsimtarëve / profesorëve	4.6%	16.4%	33.4%	20.3%	17.5%
Zyrtarëve shtetëror, publik	5.3%	28.3%	35.7%	9.4%	4.6%
Policëve	4.4%	20.5%	36.9%	11.6%	16.2%
Me rastin e marrjes së patent shoferëve	17.7%	26.3%	33.5%	7.5%	6.2%
Zyrtarëve komunal	4.7%	23.5%	41.7%	8.6%	13.6%
Gjykatësve	6.5%	32%	31%	9.5%	6.4%
Prokurorëve	5.1%	29.9%	32.9%	9.3%	6.6%
Zyrtarëve tatimor	4.9%	21.1%	41.8%	9%	8.5%
Zyrtarëve të doganës	7.8%	27.9%	33.9%	8.2%	5.5%
Procedurat e lejeve të ndërtimit	5.2%	26.9%	40.5%	7.8%	7.3%

SHUMË SHPESH

SHPESH

NDONJËHERË

RRALLË

ASNJËHERË

Përvojat e qytetarëve me shërbimet publike në Kosovë

Qytetarët e Kosovës janë pyetur gjithashtu nëse në 12 muajt e fundit kanë pasur ndonjë kontakt me zyrtarë publikë, për të kryer ndonjë shërbim, për të kërkuar informacion apo ndihmë, për të kërkuar dokumente apo për kryerjen e ndonjë procedure administrative.

Sa i përket kontaktit me policinë e Kosovës rreth 73.4% e qytetarëve kanë deklaruar se nuk kanë pasur asnjë kontakt në 12 muajt e fundit, ndërsa rreth 26.6% kanë deklaruar se kanë pasur kontakt me policinë e Kosovës. Rreth 34% e atyre që kanë pasur kontakt e kanë vlerësuar si shumë të mirë shërbimin e ofruar nga policia e Kosovës, rreth 57.4% e kanë vlerësuar si të mirë, 6.8% të keq, ndërsa si shumë të keq kanë deklaruar vetëm 1.9% e qytetarëve të anketuar.

Qytetarët e Kosovës gjithashtu janë pyetur nëse kanë pasur kontakt në 12 muajt e fundit me gjykatësit e Kosovës. Rreth 93.4% prej tyre kanë deklaruar se nuk kanë pasur kontakt, ndërkaq 6.6% e qytetarëve kanë deklaruar se kanë pasur kontakt me gjykatësit përgjatë 12 muajve të fundit. Rreth 16.9% e qytetarëve që kanë pasur kontakt me gjykatësit vlerësojnë shërbimet e ofruara si shumë të mira, rreth 49.2% i vlerësojnë si shërbime të mira, si shërbime të këqija i vlerësojnë rreth 24.6%, ndërsa si shërbime shumë të këqija i vlerësojnë rreth 9.2% e qytetarëve të Kosovës.

Më tej, qytetarët janë pyetur se a kanë pasur kontakt me prokurorë të shtetit gjatë 12 muajve të fundit. Rreth 98.3% e qytetarëve kanë deklaruar se nuk kanë pasur kontakt me prokurorë, ndërsa rreth 1.7% prej tyre kanë deklaruar të kundërtën. Nga ata që kanë pasur kontakt rreth 26.7% i kanë vlerësuar shërbimet e ofruara nga prokuroria si shumë të mira, rreth 40% si të mira, si shërbime të këqija i kanë vlerësuar rreth 6.7% e të anketuarve, ndërsa rreth 26.7% i kanë vlerësuar si shërbime shumë të këqija që i ka ofruar prokuroria, një shifër kjo mjaft shqetësuese.

Në pyetjen tjetër, nëse qytetarët kanë zhvilluar kontakte me zyrtarët komunalë, rreth 66.1% e qytetarëve të anketuar kanë deklaruar të kenë pasur kontakt në 12 muajve të fundit, ndërsa 33.9% e tyre kanë deklaruar se nuk kanë pasur kontakt fare me këta zyrtarë. Nga qytetarët që kanë pasur kontakt me zyrtarët komunalë rreth 15.4% e tyre i kanë vlerësuar si shumë të mira shërbimet e ofruara nga këta zyrtarë, si shërbime të mira i kanë vlerësuar rreth 68.6% e qytetarëve, si shërbime të këqija rreth 13.6%, ndërsa si shërbime shumë të këqija i kanë vlerësuar rreth 2.4% e qytetarëve të Kosovës.

Gjithashtu, në pyetjen nëse kanë pasur kontakt me kryetarë të komunave përgjatë 12 muajve të fundit, rreth 93.5% e të anketuarve kanë deklaruar se nuk kanë pasur fare kontakt me ta, ndërsa vetëm 6.5% e të anketuarve kanë deklaruar të kenë pasur kontakt. Prej atyre që kanë pasur kontakt, vetëm 23.8% i vlerësojnë shërbimet e ofruara nga kryetarët përkatës si shumë të mira, rreth 46% i vlerësojnë ato shërbime si të mira,

si shërbime të këqija i vlerësojnë rreth 22.2%, ndërsa si shumë të këqija i vlerësojnë rreth 7.9%.

Se a kanë pasur qytetarët e Kosovës kontakt me deputetët e Kuvendit të Kosovës në 12 muajt e fundit rezultatat tregojnë se 97.1% e tyre kanë deklaruar se nuk kanë pasur kontakt, ndërsa vetëm 2.9% e të anketuarve kanë deklaruar të kenë pasur kontakt, një shifër kjo që tregon mungesën e komunikimit absolut të deputetëve me qytetarët e Kosovës. Prej atyre që kanë deklaruar të kenë pasur kontakt me deputetët e Kosovës, rreth 32.3% i kanë vlerësuar shërbimet e ofruara si shumë të mira, rreth 48.4% i kanë vlerësuar këto shërbime si të mira, si shërbime të këqija i kanë vlerësuar rreth 19.4% e të anketuarve.


Përveç kësaj, qytetarët e anketuar njëherazi janë pyetur nëse kanë pasur kontakt në 12 muajt e fundit me anëtarët e kabinetit qeveritar. Rreth 97.4% e respondentëve në këtë hulumtim kanë deklaruar që nuk kanë pasur kontakt, ndërsa 2.6% prej tyre kanë deklaruar se kanë pasur kontakt me anëtarët e kabinetit qeveritar. Nga ata që kanë pasur kontakte në 12 muajt e fundit me anëtarët e kabinetit qeveritar rreth 14.3% i kanë vlerësuar shërbimet e ofruara si shumë të mira, rreth 47.6% si shërbime të mira, si shërbime të këqija i kanë vlerësuar rreth 28.6% e respondentëve, ndërsa si shërbime shumë të këqija i kanë vlerësuar rreth 9.5% e qytetarëve të Kosovës.

Gjatë këtij hulumtimi qytetarët e Kosovës janë pyetur nëse kanë pasur kontakt edhe me përfaqësues të organizatave jo-qeveritare në 12 muajt e fundit. Sipas të gjeturave faktike, rreth 96.6% kanë deklaruar se nuk kanë pasur kontakt, ndërsa rreth 3.4% kanë deklaruar se kanë pasur kontakt me këta përfaqësues. Rreth 44.1% e atyre që kanë pasur kontakt me përfaqësues të shoqërisë civile shërbimet e ofruara nga ky sektor i kanë vlerësuar si shumë të mira, 44.1% i kanë vlerësuar këto shërbime si të mira, rreth 5.9% prej tyre i kanë vlerësuar si shërbime të këqija, ndërsa si shërbime shumë të këqija i kanë vlerësuar rreth 5.9% e të anketuarve.


Se sa kanë qenë të kënaqur me trajtimin që i është bërë qytetarëve gjatë ofrimit të këtyre shërbimeve nga këta sektorë rreth 40.8% e respondentëve kanë deklaruar se kanë qenë gjithmonë të kënaqur, rreth 44.1% kanë deklaruar se ndonjëherë kanë qenë të kënaqur e ndonjëherë jo, ndërsa 12.9% e të anketuarve kanë deklaruar se zakonisht ata kanë qenë të pakënaqur me trajtimin e ofruar.

Në këtë pikë, qytetarët janë pyetur për arsyet e mos kënaqësisë së tyre me zyrtarët publikë. Sipas tyre, respektivisht rreth 35.5% e të anketuarve, kanë deklaruar se zyrtarët publik nuk kanë punuar aq sa duhet, rreth 13.8% kanë deklaruar se zyrtarët nuk kanë qenë të sjellshëm, ndaj tyre, 7.2% kanë deklaruar se zyrtarët publikë janë treguar jo kompetentë, që nuk kanë qenë mjaft të përgatitur kanë deklaruar rreth 14% e të anketuarve, rreth 15.9% kanë deklaruar se zyrtarët nuk i kanë zgjidhur problemet për të cilat kanë pasur nevojë qytetarët, ndërsa 3.5% kanë bërë më dije që është


Sa janë të pranueshme sjelljet




Mjeku që kërkon para/dhuratë në shkëmbim të mjekimit/trajtimit më të mirë




Ofrimi i parave/dhuratave mjekimit/trajtimit




Zyrtari publik i cili është punësuar përmes lidhjeve familjare apo përmes shoqërisë




Polici i komunikacionit i cili holla në vend se t'ia s'




Arsimtari / profesori i cili kërkon para/dhuratë për t'u sjellë më mirë me fëmijët në shkollë




Ofrimi i parave/dhuratave ar t'u sjellë më mirë me nxënë ta dhënë më lehtë




Ofrimi i parave zyrtarit publik, për ta përsheptuar procedurën administrative



Zyrtari publik i cili pranon private e cila punon për ins është i punësuar




Prokurorit që i ofrohen para/dhuratë në mënyrë që të mos ju hetojë




Gjykatësi që kërkon para/dhuratë që të mos ju d'

SHUMË SHPESH SHPESH NDONJËHERË


Ujjet vijuese korruptive për ju?




... në shkëmbim të ...
... në të mirë




Zyrtari publik i cili kryen edhe ndonjë punë private, për t'i rritur të ardhurat




... kërkon nga vozitësi të ...
... shqiptojë dënimin




Ofrimi i të hollave policit të komunikacionit, në vend se të shqiptojë dënimin




... simtarit/profesorit për ...
... sin/studentin, apo për ...
... të provimin




Zyrtari publik i cili kërkon të holla apo dhurata, për ta përsheptuar procedurën administrative




... dhurata nga një firmë ...
... stitucionin në të cilin ...
... ar zyrtari



Prokurori që kërkon para/dhuratë në mënyrë që të mos ju hetojë




... dhuratë në mënyrë ...
... ënojë




Gjykatësitë që i ofrohen para/dhuratë në mënyrë që mos të ju dënojnë

dashur t'u ofrojnë para zyrtarëve në mënyrë që të iu kryejnë shërbimet.


Në 12 muajt e fundit, a keni pasë ndonjë kontakt me zyrtarët vijues shtetëror/publik?




Sa keni qenë të kënaqur me mënyrën se si ju kanë trajtuar?



Sa janë të shpeshtë mënyrat vijuese të sjelljes në mesin e përfaqësuesve/politikanëve të zgjedhur tek ne?



Si e vlerësoni cilësinë e shërbimeve të fituara?



Përvojat me ryshfet

Gjatë realizimit të këtij hulumtimi qytetarëve të anketuar iu është kërkuar të kujtojnë të gjitha kontaktet që i kanë pasur me zyrtarët publikë në 12 muajt e fundit. Nëse qytetarët janë përgjigjur pozitivisht, që kanë takuar zyrtarët publikë, ata janë pyetur nëse dikujt prej zyrtarëve është dashur t'u japin dhuratë, t'u ofrojnë shërbim në këmbim të favoreve të caktuara, apo t'u japin të holla. Nga të anketuarit rezultoi se rreth 5.54% prej tyre kanë deklaruar kjo të iu ketë ndodhur, rreth 84% kanë deklaruar se kjo nuk iu ka ndodhur asnjëherë, rreth 3.6% janë deklaruar të pasigurtë, ndërsa kanë refuzuar të përgjigjen rreth 6.9% e të anketuarve.

Përveç kësaj, Lëvizja FOL ka kërkuar nga qytetarët e anketuar për të bërë listimin e institucioneve dhe sektorëve publikë, që sipas tyre u kanë kërkuar dhurata apo para shtesë në 12 muajt e fundit. Sa i përket policisë së Kosovës, rreth 85.2% e të anketuarve kanë deklaruar se nuk u kanë dhënë asnjëherë para ndërsa, 14.8% e tyre kanë deklaruar se gjatë 12 muajve të fundit policisë iu është dhënë para.

Në rastin e gjykatësve, rreth 94.6% e qytetarëve të anketuar kanë deklaruar se nuk u kanë dhënë para gjatë 12 muajve të fundit, ndërsa 5.4% kanë deklaruar se këtë e kanë bërë gjatë kësaj periudhe.

Sa i përket prokurorëve rreth 98.2% e qytetarëve kanë deklaruar se gjatë periudhës 12 mujore nuk u kanë dhënë para, ndërsa vetëm 1.8% kanë deklaruar se u kanë dhënë para prokurorëve.

Gjithashtu, qytetarët janë pyetur nëse është dashur që t'u japin para ose dhurata zyrtarëve të zyrave kadastrale për regjistrim të tokave. Rreth 86% e të anketuarve kanë deklaruar që një gjë e tillë të mos iu ketë ndodhur, ndërsa 14% prej tyre kanë deklaruar se është dashur që t'u japin para këtyre zyrtarëve kur u është dashur që të regjistrojnë tokat ose pronat e tyre.

Sa i përket dhënies së ryshfetit zyrtarëve tatimorë, rreth 96.4% e të anketuarve janë përgjigjur se në periudhën e fundit 12 mujore nuk u ka rënë që t'u japin ryshfet këtyre zyrtarëve, ndërsa 3.6% kanë pohuar se u është dashur që t'u japin ryshfet zyrtarëve tatimorë.

Qytetarët gjithashtu janë pyetur edhe rreth përvojave të tyre në dhënien e ryshfetit për zyrtarët doganorë. Rreth 90.9% e të anketuarve janë përgjigjur që një gjë e tillë nuk iu ka ndodhur, kurse 9.1% e tyre kanë deklaruar se në 12 muajt e fundit iu është dashur që të japin ryshfet këtyre zyrtarëve.

Në rastin e ndërmarrjeve publike, rreth 87.7% e të anketuarve kanë deklaruar se në 12 muajt e fundit nuk iu ka ndodhur të kenë dhënë ryshfet për zyrtarët e ndërmarrjeve publike, ndërsa 12.3% e qytetarëve kanë deklaruar se iu kanë dhënë ryshfet.

Sa i përket dhënies së ryshfetit zyrtarëve komunalë, rreth 85.5% e qytetarëve kanë deklaruar të mos iu kenë dhënë ryshfet, ndërsa 14.5%

e të anketuarve kanë deklaruar të iu kenë dhënë rryshfet këtyre zyrtarëve përgjatë 12 muajve të fundit.

Në sektorin e shëndetësisë, sipas të dhënave të këtij hulumtimi, del se dhënia e rryshfetit është e nivelit me të lartë. Rreth 58.2% e të anketuarve kanë deklaruar se nuk u kanë dhënë rryshfet mjekëve në sektorin shëndetësor publik, ndërsa rreth 41.8% e qytetarëve, një shifër mjaft e lartë kjo, kanë deklaruar se gjatë 12 muajve të fundit u kanë dhënë rryshfet mjekëve të sektorit publik shëndetësor.

Gjithashtu, qytetarët janë pyetur rreth përvojave të tyre në dhënien e rryshfetit në sektorin e arsimit në Kosovë. Rreth 99.3% e qytetarëve kanë deklaruar se nuk iu ka ndodhur që të japin rryshfet, ndërsa rreth 0.7% e të anketuarve kanë deklaruar të iu ketë ndodhur që në 12 muajt e fundit të japin rryshfet zyrtarëve të këtij sektori.

Ndërsa sa i përket përvojës së qytetarëve rreth dhënies se rryshfetit për zyrtarët nga departamenti për mirëqenie sociale, sidomos në sektorët e pensioneve dhe ndihmave sociale, rreth 96.4% e të anketuarve kanë deklaruar se nuk iu ka ndodhur që të japin rryshfet këtyre zyrtarëve, ndërsa rreth 3.6% e qytetarëve kanë deklaruar se iu kanë dhënë rryshfet zyrtarëve të mirëqenies sociale në 12 muajt e fundit.

Në pyetjen tjetër, nëse qytetarët kanë paguar zyrtarët për marrjen e patentë shoferëve, rreth 88.9% janë përgjigjur se nuk iu ka ndodhur që këtyre zyrtarëve tu jepet rryshfet në 12 muajt e fundit, ndërsa rreth 11.1% e qytetarëve janë përgjigjur se iu ka ndodhur që t'u japin rryshfet këtyre zyrtarëve.

Qytetarët e Kosovës janë pyetur gjithashtu se a ka pasur raste kur është dashur që të japin rryshfet kryetarëve të komunave. Rreth 99.6% e të anketuarve kanë deklaruar se asnjëherë nuk iu ka ndodhur që t'u japin rryshfet kryetarëve të komunave në 12 muajt e fundit, ndërsa vetëm 0.4% kanë deklaruar se iu kanë dhënë rryshfet këtyre zyrtarëve.

Qytetarët janë pyetur po ashtu nëse kanë pasur raste të dhënies së rryshfetit deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Bazuar në të gjeturat e hulumtimit, asnjëri nga qytetarët nuk ka thënë që ka pasur ndonjë përvojë të tillë më këta zyrtarë.

Ndërsa kur janë pyetur për përvojat në raport me anëtarët e kabinetit qeveritar, rreth 98.2% e qytetarëve të anketuar kanë deklaruar se nuk kanë pasur ndonjë përvojë të dhënies së rryshfetit, ndërsa 1.8% e qytetarëve kanë deklaruar se iu kanë dhënë rryshfet anëtarëve të kabinetit qeveritar në 12 muajt e fundit.

Qytetarët e anketuar gjithashtu janë pyetur se cilëve zyrtarë publikë iu është dashur së fundmi t'u jepet rryshfet. Rreth 9.4% janë përgjigjur se policisë iu është dashur t'u japin rryshfet, rreth 3.8% gjykatësve, zyrtarëve të zyrave kadastrale apo regjistrimit të tokave rreth 5.7%, rreth 7.5% e qytetarëve kanë deklaruar zyrtarëve doganorë, zyrtarëve të ndërmarrjeve publike kanë deklaruar rreth 1.9%, 5.7% zyrtarëve komunalë, 47.2%

99.6%

e të anketuarve kanë deklaruar se asnjëherë nuk iu ka ndodhur që t'u japin rryshfet kryetarëve të komunave në 12 muajt e fundit.

mjekëve të sektorit publik, 3.8% zyrtarëve të mirëqenies sociale, si dhe rreth 9.4% e qytetarëve kanë deklaruar të iu kenë dhënë zyrtarëve të autorizuar për lëshimin e patentë shoferëve.

Se çfarë gjinie kanë pasur zyrtarët publikë që kanë marrë ryshfet herën e fundit rreth 77.2% kanë deklaruar se zyrtarët kanë qenë të gjinisë mashkullore, rreth 14% kanë deklaruar se kanë qenë zyrtarë të gjinisë femërore, ndërsa rreth 8.8% kanë deklaruar që nuk e dinë gjininë e zyrtarëve që u është dashur t'u jepet ryshfet.

Gjithashtu, qytetarët që kanë dhënë ryshfet se fundmi janë pyetur se çfarë kanë dhënë ata në formë ryshfeti. Rreth 8.7% e të anketuarve kanë deklaruar se kanë dhënë ushqim, rreth 12.2% kanë deklaruar se kanë dhënë objekte me vlerë, si stoli, telefona etj., ndërsa 78.9% kanë deklaruar se kanë dhënë të holla si formë ryshfeti.

Qytetarët e anketuar janë pyetur se për çfarë procedure administrative është dashur që të japin ryshfet se fundmi. Rreth 2.4% prej tyre kanë deklaruar se është dashur të japin ryshfet për nxjerrjen ose pajisjen me vërtetime ose dokumente zyrtare, si letërnjoftimet, pasaportat apo certifikatat e lindjes. Për posedim me leje ndërtimi kanë deklaruar rreth 6.4% e qytetarëve, për vizita, kontrolle ose intervenime mjekësore kanë deklaruar rreth 32.9% e respondentëve, për nxjerrjen e vërtetimeve për gjendje shëndetësore kanë deklaruar rreth 4.9%, për shmangie nga dënimet administrative rreth 7.5%, për shmangie të konfiskimit të patentë shoferëve rreth 9.9%, për punësim në sektorin publik rreth 3.6%, për avancim në pozita publike 2.4%, për marrëveshje në prokurimin publik rreth 4.9%, për lirim nga tatimi në import dhe eksport rreth 4.9%, ndërsa kanë refuzuar të përgjigjen 11.8% e qytetarëve të Kosovës.

Ndërsa kur qytetarët e Kosovës janë pyetur se për çfarë qëllimi kanë dhënë ryshfet, rreth 29.2% e tyre kanë deklaruar se kanë dhënë ryshfet për përshpejtim të procedurave, rreth 20.3% kanë deklaruar se këtë e kanë bërë për përfundim të procedurave, për shmangie të dënimeve të ndryshme janë deklaruar rreth 14.1%, për marrje të trajtimit më të mirë kanë deklaruar rreth 14.7%, si dhe kanë refuzuar të përgjigjen rreth 13% e të anketuarve.

Qytetarët e anketuar gjithashtu janë pyetur se kur kanë dhënë ryshfet në kohëve fundi, dhe kur saktësisht i kanë dhënë ato. Rreth 64.6% e të anketuarve kanë deklaruar se kanë dhënë ryshfet para ofrimit të shërbimit nga ana e zyrtarëve publikë, rreth 10.7% kanë deklaruar se ryshfet kanë dhënë pas ofrimit të shërbimit, 9.7% e të anketuarve kanë deklaruar se ryshfet kanë dhënë në momentin kur është ofruar shërbimi, ndërsa rreth 12.6% kanë refuzuar të përgjigjen.

Gjatë këtij hulumtimi vërehet shkallë e ultë e raportimit të korrupsionit nga ana e qytetarëve të Kosovë në institucionet përkatëse. Vetëm 2.4% e të anketuarve që kanë deklaruar që kanë dhënë ryshfet kanë deklaruar se këtë e kanë raportuar tek institucionet anti-korrupsion, ndërsa rreth

97.6% e të anketuarve kanë deklaruar se asnjëherë nuk kanë raportuar tek këto institucione kur është dashur që të japin ryshfet. Dhe ata që kanë deklaruar se kanë raportuar kur dhënë ryshfet kanë thënë se këtë e kanë bërë tek institucioni ku ka punuar zyrtari i cili ka kërkuar ryshfet dhe se institucioni ka nisur procedura zyrtare kundër zyrtarit.

Ndërsa ata që nuk e kanë raportuar korrupsionin në institucionet përkatëse janë pyetur se pse nuk e kanë bërë një gjë të tillë. Rreth 9.4% e të anketuarve kanë deklaruar se nuk e kanë raportuar korrupsionin sepse është praktikë e zakonshme që të jepet ryshfet në Kosovë. Rreth 26.3% kanë deklaruar se nuk ia vlen të raportohet sepse askush nuk do që të merret seriozisht me raportimet e qytetarëve, rreth 1.1% kanë deklaruar se nuk dinë ku duhet të lajmërohen raste të tilla, se kanë frikë nga pasojat kanë deklaruar rreth 15.2% e të anketuarve, rreth 32.2% kanë deklaruar se kanë pasur dobi nga dhënia e ryshfetit dhe se nuk kanë pasur arsye të raportojnë, 10.2% e të anketuarve kanë deklaruar se kanë dhënë ryshfet në shenjë falënderimi, ndërsa 5.6% e të anketuarve kanë deklaruar arsye të tjera.

Gjithashtu qytetarët e anketuar janë pyetur se a ka ndodhur që gjatë 12 muajve të fundit të ketë pasur ndonjë rast kur zyrtarët publikë u kanë kërkuar ryshfet por që ata kanë refuzuar ta bëjnë një gjë të tillë. Sipas të gjeturave të hulumtimit, rreth 20.6% e të anketuarve kanë deklaruar se një gjë e tillë ka ndodhur, rreth 73.2% kanë deklaruar se kjo nuk u ka ndodhur, ndërsa 6.2% e të anketuarve kanë refuzuar të përgjigjen në këtë pyetje.


35.5%

e të anketuarve, kanë deklaruar se zyrtarët publik nuk kanë punuar aq sa duhet


Në rastet kur nuk keni qenë të kënaqur

Nuk kanë punuar sa duhet	35.5%
Nuk kanë qenë të këndshëm ndaj meje	13.8%
Nuk kanë qenë kompetent	7.2%
Nuk kanë qenë mjaft të përgatitur	14%
Nuk e kanë zgjidhur problemin	15.9%
Ma kanë bërë me dije se dëshirojnë që t'ju ofrojë para	3.5%

Deri në çfarë mase pajtoheni apo nuk pajtoheni me deklaratat e mëposhtme në lidhje me lajmërimin e korrupsionit?



Nëse në të ardhmen ju duhet ta lajmëroni një rast kur një zyrtar i shtetit ka kërkuar para apo dhuratë nga ju, te kush e kishit lajmëruar?



Qëndrimet dhe përvojat e qytetarëve në lidhje me raportimin e korrupsionit në institucione

Qytetarët e anketuar janë pyetur se deri në çfarë mase ata pajtohen apo nuk pajtohen me deklaratat e mëposhtme në lidhje me lajmërimin e korrupsionit. Në lidhje me deklaratën: “është praktikë e zakonshme që të paguhet apo të jepen dhurata, pse ta lajmërojë, rreth 5.6% e qytetarëve janë pajtuar në tërësi me këtë deklaratë, 20% e qytetarëve kanë shprehur pajtimin e tyre me këtë deklaratë, rreth 45.7% e të anketuarve janë shprehur se nuk pajtohen me këtë deklaratë, ndërsa 24.3% e të anketuarve kanë deklaruar se nuk pajtohen fare me deklaratën se është praktikë e zakonshme që të paguhet apo të jepen dhurata, pse ta lajmërojë institucionet përkatëse.

Gjithashtu qytetarët janë pyetur se deri në çfarë mase pajtohen apo nuk pajtohen me deklaratën se “nuk ia vlen të lajmërohet korrupsioni sepse nuk mund të bëhet asgjë e dobishme në lidhje me atë çështje.” Rreth 9.1% e qytetarëve pajtohen në tërësi me këtë deklaratë, 16% e qytetarëve pajtohen me këtë deklaratë, rreth 42.7% e qytetarëve nuk pajtohen me këtë deklaratë, kurse 27.8% e qytetarëve nuk pajtohen fare me deklaratën se nuk ia vlen të lajmërohet korrupsioni me arsyetimin se nuk mund të bëhet asgjë e dobishme në lidhje me këtë çështje.

Më tutje, të anketuarit janë pyetur se deri në çfarë mase pajtohen apo nuk pajtohen me deklaratën se “njerëzit të cilët lajmërojnë korrupsionin, me siguri do të pendohen për këtë.” Rreth 8.3% e qytetarëve të Kosovës pajtohen në tërësi me këtë deklaratë, pajtohen me këtë deklaratë rreth 25%, nuk pajtohen rreth 39.3% e qytetarëve të Kosovës me këtë deklaratë ndërsa 20.4% e respondentëve kanë deklaruar se nuk pajtohen fare me deklaratën se njerëzit të cilët lajmërojnë korrupsionin, me siguri do të pendohen për këtë.

Përpos kësaj, qytetarët janë pyetur se deri në çfarë mase pajtohen apo nuk pajtohen me deklaratën se “ndonjëherë korrupsioni është e vetmja mënyrë për t'i kryer gjërat.” Rreth 3.5% e të anketuarve janë pajtuar në tërësi me këtë deklaratë, rreth 20.7% janë pajtuar me këtë deklaratë, me këtë deklaratë nuk janë pajtuar 42.5% e qytetarëve, kurse rreth 24.7% e qytetarëve të anketuar nuk pajtohen fare me deklaratën e lartpërmendur: “ndonjëherë korrupsioni është e vetmja mënyrë për t'i kryer gjërat.”

Po ashtu, në këtë seksion qytetarët janë pyetur se deri në çfarë mase pajtohen apo nuk pajtohen me deklaratën se “askush nuk e dinë se ku lajmërohen veprat e korrupsionit.” Rreth 1.8% e të anketuarve kanë deklaruar se pajtohen në tërësi me këtë deklaratë, 8.5% prej tyre kanë deklaruar se pajtohen me këtë deklaratë, rreth 50.8% e të anketuarve nuk pajtohen me këtë deklaratë, ndërsa 32.6% e qytetarëve të Kosovës nuk pajtohen fare me një deklaratë të tillë.

Në këtë seksion të hulumtimit qytetarët e anketuar janë pyetur se nëse

në të ardhmen duhet lajmëruar një rast kur një zyrtar i shtetit ka kërkuar para apo dhuratë nga ata, cilit autoritet do t'i drejtoheshin. Në këtë pyetje, qytetarëve të anketuar u janë ofruar tre opsione.

Për opsionin e parë, se cilit autoritet do t'i drejtoheshin së pari për të lajmëruar korrupsionin, rreth 10% e qytetarëve janë përgjigjur se e kishin lajmëruar tek eprori në institucionin e njëjtë ku zyrtari ka kërkuar ryshfet, rreth 55.4% kanë deklaruar se këtë e kishin lajmëruar në polici, 6.4% prej tyre kanë deklaruar se lajmërimin e kishin bërë në prokurori, rreth 11.6% kanë deklaruar se këtë e kishin raportuar në Agjencinë Kundër Korrupsion, tek Avokati i Popullit kanë deklaruar se e kishin raportuar rreth 1.5%, raportimin tek mediat e kanë deklaruar rreth 4.1% e respondentëve, tek organizatat joqeveritare kanë deklaruar vetëm 0.9% e të anketuarve, dhe se nuk do ta lajmëronin askënd kanë deklaruar vetëm 5.9% e qytetarëve të Kosovës.

Për opsionin e dytë, se te cili autoritet do ta lajmëronin së dyti korrupsionin, rreth 6% e qytetarëve janë përgjigjur se e kishin lajmëruar tek eprori në institucionin e njëjtë ku zyrtari ka kërkuar ryshfet, rreth 17.1% kanë deklaruar se këtë e kishin lajmëruar në polici, 24.5% prej tyre kanë deklaruar se lajmërimin e kishin bërë në prokurori, rreth 18% kanë deklaruar se këtë e kishin raportuar në Agjencinë Kundër Korrupsion, tek Avokati i Popullit kanë deklaruar se e kishin raportuar rreth 1.5%, raportimin tek mediat e kanë deklaruar rreth 9.2% e respondentëve, tek organizatat joqeveritare kanë deklaruar vetëm 2.5% e të anketuarve, dhe se nuk do ta lajmëronin askënd kanë deklaruar rreth 8.8% e qytetarëve të Kosovës.

Për opsionin e tretë, se te kush do ta lajmëronin së treti korrupsionin, rreth 5.5% e qytetarëve janë përgjigjur se një gjë të tillë do ta bënin tek eprori në institucionin e njëjtë ku zyrtari ka kërkuar ryshfet, rreth 6.5% kanë deklaruar se këtë e kishin lajmëruar në polici, 10.3% prej tyre kanë deklaruar se lajmërimin do ta bënin në prokurori, rreth 18.9% kanë deklaruar se këtë do ta bënin në Agjencinë Kundër Korrupsion, tek Avokati i Popullit kanë deklaruar se e kishin raportuar rreth 4.5%, raportimin tek mediat e kanë deklaruar rreth 17% e respondentëve, tek organizatat joqeveritare kanë deklaruar vetëm 6.9% e të anketuarve, dhe se nuk do ta lajmëronin askënd kanë deklaruar rreth 11.8% e qytetarëve të Kosovës.

Nga një renditje e përgjithshme del se qytetarët e Kosovës nëse iu bie të raportojnë korrupsionin rreth 55.5% e qytetarëve të anketuar kanë deklaruar se fillimisht këtë do ta bënin tek Policia e Kosovës, si opsion të dytë rreth 24.5% e qytetarëve kanë deklaruar se korrupsionin do ta raportonin në Prokurori, ndërsa si opsion të tretë rreth 19% e qytetarëve të anketuar e kanë përzgjedhur Agjencinë Kundër Korrupsion.

55.5%

të qytetarëve të anketuar kanë deklaruar se fillimisht do ta raportonin korrupsionin tek Policia e Kosovës.

A keni konkurrar ju apo ndonjë anëtar i familje suaj, për ndonjë vend pune në sektorin publik, më së paku një herë në 3 vitet e fundit?

Po 30.6%

Jo 69.4%

Kur keni konkurrar herën e fundit për një vend të punës, a e keni fituar atë punë Ju apo anëtari i familjes suaj?

Po 14.7%

Jo 85.3%

A ju është dashur Juve apo anëtarit të familjes suaj të jepni para, dhuratë, apo të ofroni dikujt shërbim si këmbim për ndonjë shërbim për t'ju punësuar më lehtë?

Po 14.7%

Jo 85.3%

Çfarë mendoni, pse Ju apo anëtari i familjes suaj nuk e keni fituar atë punë?

Punën e ka fituar dikush që i plotëson më mirë kushtet për një vend të punës 4%

Punën e ka fituar dikush që ka miq/kushërinj në atë institucion 50.2%

Punën e ka fituar dikush që ka dhënë para 17.7%

Nuk janë të sigurt 16.6%

Kanë refuzuar të përgjigjen 10.5%

Cilëve zyrtarë publik u është dashtë të ju jepni ryshfet së fundi ?



Qëllimi i dhënies së ryshfetit



5.5% pohojnë dhënien e ryshfetit

84% mohojnë dhënien e ryshfetit

Kur jeni dashtë herën e fundit apo dhuratë shtesë, për cilën administrative e keni bërë këtë




Kur saktësisht keni dhënë rryshfet

- Para ofrimit të shërbimit **64.6%**
- Pas ofrimit të shërbimit **10.7%**
- Në momentin kur është ofruar shërbimi **9.7%**
- Refuzon të përgjigjet **12.6%**



8.7%
ushqim

12.2%
objekte me vlerë



78.9%
të rryshfeteve të dhëna janë para

nia e zyrtarit
 mashkull **77.2%**
 femër **14%**
 nuk e di **8.8%**

Ju lutem tregoni sa ka qenë shuma: Sa EURO?



6.7% **13.1%** **30.6%** **11.7%**

1500 euro **10 euro** **30 euro**
5.9% **4.3%** **3.4%**

(25€ 10€ 80€ 150€ 170€ 500€ 1200€)

2.9%

të jepni para
 procedurë
 ë?


uar të
 ✗

nga dënimet
 tive **100€**

en e vërtetimeve
 e shëndetësore




Kombësia



Vendbanimi

Sektori i punësimit

Gjinia



Përvojat e Qytetarëve me procesin e punësimit në sektorin publik

Gjatë realizimit të këtij hulumtimi Lëvizja FOL gjithashtu është interesuar dhe ka pyetur qytetarët e anketuar rreth përvojave të tyre në procesin e punësimit në sektorin publik dhe mundësitë e identifikimit të keqpërdorimeve gjatë këtyre proceseve.


Qytetarët e anketuar janë pyetur se a kanë konkurruar ata apo ndonjë anëtar i familje së tyre, për ndonjë vend pune në sektorin publik, së paku një herë në 3 vitet e fundit. Rreth 30.6% e të anketuarve kanë deklaruar se ata ose ndonjë anëtar i familjes së tyre ka konkurruar për vend pune në sektorin publik, ndërsa rreth 69.4% kanë deklaruar se asnjëherë nuk kanë konkurruar për ndonjë vend pune në sektorin publik.

Ata gjithashtu janë pyetur se kur kanë konkurruar për herë të fundit për një vend pune në sektorin publik a e kanë fituar atë punë ata ose anëtarët e familjes se tyre. Vetëm rreth 14.7% kanë deklaruar se e kanë fituar atë vend të punës, ndërsa 85.3% kanë deklaruar se nuk kanë mundur që të punësohen në sektorin publik edhe pse kanë konkurruar.


Për ata që janë përgjigjur se janë punësuar në sektorin publik janë pyetur se a u është dashur që të japin ryshfet ose të ofrojnë ndonjë shërbim në këmbim për t'u punësuar më lehtë. Rreth 9.7% prej tyre kanë deklaruar se është dashur që të japin ryshfet në mënyrë që të punësohen, ndërsa 84.4% prej tyre e kanë mohuar këtë gjë.

Ndërsa për ata që nuk kanë mundur të punësohen në sektorin publik janë pyetur se çfarë mendojnë për arsyet se pse ata ose anëtarët e familjeve të tyre nuk kanë mundur të punësohen në pozitat që kanë aplikuar në sektorin publik. Rreth 4% prej tyre kanë deklaruar se atë pozitë e ka fituar dikush që i ka plotësuar kushtet për atë vend të punës, 50.2% e të anketuarve mendojnë se punën e kanë fituar ata që kanë miq ose të afërm që punojnë në institucione publike, rreth 17.7% kanë deklaruar se punën e kanë fituar ata që kanë dhënë para për këtë, që nuk janë të sigurt janë deklaruar rreth 16.6%, ndërsa kanë refuzuar të përgjigjen 10.5% e të anketuarve.

Në krahasim me periudhën e para tri vjetëve, a mendoni që niveli i korrupsionit në Kosovë në përgjithësi është rritur, ka mbetur i njëjtë apo është zvogëluar?



Grupmosha



Rajoni



Të dhënat demografike të hulumtimit

Hulumtimi i Lëvizjes FOL është realizuar në 7 rajonet e Kosovës duke përfshirë gjithsej 38 komuna. Në rajonin e Prishtinës janë intervistuar 255 qytetarë ose 25.5% nga totali i mostrës, në rajonin e Prizrenit janë intervistuar 178 qytetarë ose 17.8% nga totali i mostrës, në rajonin e Mitrovicës janë intervistuar 139 qytetarë ose rreth 13.9% nga totali i mostrës, në rajonin e Ferizajt janë intervistuar 111 qytetarë ose 11.1% nga totali i mostrës, në rajonin e Gjakovës janë intervistuar 117 qytetarë ose 11.7% nga totali i mostrës, në rajonin e Gjilanit janë intervistuar 104 qytetarë ose 10.4% nga totali i mostrës dhe në rajonin e Pejës janë intervistuar 97 qytetarë ose 9.7% nga totali i mostrës së hulumtimit.

Janë realizuar 568 intervista në fshatra ose 56.8% nga totali i mostrës, ndërsa janë realizuar 432 intervista në qytete ose 43.2% nga totali i mostrës së hulumtimit.

Gjatë realizimit të hulumtimit janë intervistuar 509 qytetarë të gjinisë mashkullore ose 50.9% nga totali i mostrës, ndërsa janë intervistuar 491 qytetarë të gjinisë femërore ose 49.1% nga totali i mostrës së hulumtimit.

Anketimi është realizuar me qytetarë të moshës nga 18 deri 75 vjeç. Rreth 252 të anketuar kanë qenë të grupmoshës nga 18 deri në 24 vjeç ose 25.2% nga totali i mostrës, 175 të anketuar kanë qenë të grupmoshës nga 25 deri në 30 vjeç ose rreth 17.5% nga totali i mostrës, 204 të anketuar kanë qenë të grupmoshës nga 31 deri në 40 vjeç ose rreth 20.4% nga totali i mostrës, 184 të anketuar kanë qenë të grupmoshës nga 41 deri në 50 vjeç ose rreth 18.4% nga totali i mostrës, 123 të anketuar kanë qenë të grupmoshës nga 51 deri në 60 vjeç ose rreth 12.3% nga totali i mostrës, 47 të anketuar kanë qenë të grupmoshës nga 61 deri në 70 vjeç ose 4.7% nga totali i mostrës dhe 15 të anketuar kanë qenë të grupmoshës nga 71 deri në 75 vjeç ose 1.5% nga totali i mostrës së hulumtimit.

Sa i përket nivelit të edukimit rreth 2.5% e të anketuarve janë deklaruar se janë pa shkollim, 16.5% e të anketuarve kanë deklaruar se kanë të përfunduar shkollën fillore, 57.1% e të anketuarve kanë deklaruar se kanë të përfunduar shkollimin e mesëm, shkollën e lartë që e kanë të përfunduar kanë deklaruar rreth 3.5% e të anketuarve, rreth 17.4% e të anketuarve kanë deklaruar se kanë të përfunduar shkollimin universitar dhe 3.1% e të anketuarve kanë deklaruar se kanë të përfunduar studimet e magjistraturës ose doktoratës.









Gjithashtu gjatë realizimit të këtij hulumtimi qytetarët e anketuar janë pyetur për statusin e punësimit të tyre. Rreth 1.6% e të anketuarve kanë deklaruar se janë punëdhënës, rreth 29.2% e të anketuarve kanë deklaruar se janë të punësuar, rreth 4.6% e të anketuarve kanë deklaruar se janë të vetëpunësuar, rreth 2.3% e të anketuarve kanë deklaruar se punojnë në pronat e tyre familjare, rreth 30% e të anketuarve kanë deklaruar se janë të papunë, 12.2% e të anketuarve kanë deklaruar se janë studentë,

15% e të anketuarve kanë deklaruar se janë shtëpiakë/e dhe 4.4% kanë deklaruar se janë pensionistë.







Nga ata që kanë deklaruar se janë të punësuar 77% e tyre kanë deklaruar se punojnë në sektorin privat, ndërsa 22.6 prej tyre kanë deklaruar se punojnë në sektorin publik.

Sa i përket kombësisë së respondentëve rreth 93% e të anketuarve kanë qenë shqiptarë, 4% e të anketuarve kanë qenë nga komuniteti serb, 1.2% e të anketuarve kanë qenë nga ai ashkalinj, 0.5% kanë qenë goran, 0.5% e të anketuarve kanë qenë turq, 0.4% e të anketuarve kanë qenë boshnjakë dhe 0.4% e të anketuarve kanë qenë rom.

Statusi i punësimit

Punëdhënës	1.6%	
I/e punësuar	29.2%	
I/e vetëpunësuar	4.6%	
Punojë në pronën familjare	2.3%	
I/e papunësuar	30%	
Student	12.2%	
Shtëpiak/e	15%	
I/e pensionuar	4.4%	

Niveli i edukimit

Pa shkollim	2.5%	
Shkollim fillor	16.5%	
Shkollim të mesëm	57.1%	
Shkollë të lartë	3.5%	
Shkollim universitar	17.4%	
Studimet të magjistraturës/doktoraturës	3.1%	

ANEKS

Tabelat e përgjigjeve të qytetarëve në bazë të regjioneve

Sa shpesh është i pranishëm korrupsioni në institucionet/sectorët e listuar më poshtë sipas regjioneve?

Kuvendi i Kosovës								
								Total
		Shumë shpesh	Shpesh	Ndonjëherë	Rrallë	Asnjëherë	Nuk e di	
Regjioni	Prishtina	48.2%	29.8%	16.9%	0.8%	1.2%	3.1%	100.0%
	Mitrovica	40.0%	41.4%	15.0%	2.1%	0.7%	0.7%	100.0%
	Prizreni	14.1%	31.6%	35.0%	14.1%	0.6%	4.5%	100.0%
	Peja	11.5%	27.1%	25.0%	16.7%		19.8%	100.0%
	Ferizaj	2.7%	17.1%	32.4%	37.8%	9.0%	0.9%	100.0%
	Gjakova	12.7%	22.9%	52.5%	5.9%		5.9%	100.0%
	Gjilan	2.9%	78.1%	12.4%	3.8%	1.0%	1.9%	100.0%
Total		23.6%	34.3%	26.0%	9.9%	1.6%	4.6%	100.0%

Qeveri								
								Total
		Shumë shpesh	Shpesh	Ndonjëherë	Rrallë	Asnjëherë	Nuk e di	
Regjioni	Prishtina	59.2%	29.4%	9.0%	0.8%	0.8%	0.8%	100.0%
	Mitrovica	47.5%	33.8%	15.8%	2.9%			100.0%
	Prizreni	43.8%	36.5%	12.9%	1.7%	1.7%	3.4%	100.0%
	Peja	38.1%	53.6%	8.2%				100.0%
	Ferizaj	21.4%	63.4%	14.3%	0.9%			100.0%
	Gjakova	26.5%	43.6%	28.2%	0.9%	0.9%		100.0%
	Gjilan	16.2%	67.6%	11.4%	2.9%	1.0%	1.0%	100.0%
Total		40.3%	43.1%	13.7%	1.4%	0.7%	0.9%	100.0%

Komuna								
								Total
		Shumë shpesh	Shpesh	Ndonjëherë	Rrallë	Asnjëherë	Nuk e di	
Regjioni	Prishtina	34.0%	27.0%	18.0%	6.6%	9.8%	4.7%	100.0%
	Mitrovica	41.0%	36.0%	13.7%	5.8%	2.2%	1.4%	100.0%
	Prizreni	24.9%	24.3%	32.8%	11.3%	3.4%	3.4%	100.0%
	Peja	30.9%	48.5%	15.5%	2.1%		3.1%	100.0%
	Ferizaj	10.9%	67.3%	14.5%	6.4%	0.9%		100.0%
	Gjakova	9.4%	22.2%	58.1%	3.4%	0.9%	6.0%	100.0%
	Gjilan	17.3%	67.3%	12.5%	1.0%	1.0%	1.0%	100.0%
Total		25.9%	37.9%	23.5%	5.9%	3.7%	3.1%	100.0%

Gjykata								
								Total
		Shumë shpesh	Shpesh	Ndon-jëherë	Rrallë	Asnjëherë	Nuk e di	
Regjioni	Prishtina	48.4%	24.0%	13.4%	3.1%	1.2%	9.8%	100.0%
	Mitrovica	36.4%	37.9%	14.3%	6.4%	4.3%	0.7%	100.0%
	Prizreni	19.7%	16.9%	30.3%	25.8%	1.7%	5.6%	100.0%
	Peja	18.8%	51.0%	11.5%			18.8%	100.0%
	Ferizaj	8.1%	71.2%	17.1%	2.7%		0.9%	100.0%
	Gjakova	6.8%	32.5%	44.4%	9.4%		6.8%	100.0%
	Gjilan	16.3%	67.3%	10.6%	2.9%	1.0%	1.9%	100.0%
Total		26.1%	38.0%	20.1%	8.0%	1.3%	6.5%	100.0%

Prokurori								
								Total
		Shumë shpesh	Shpesh	Ndon-jëherë	Rrallë	Asnjëherë	Nuk e di	
Regjioni	Prishtina	43.1%	22.0%	13.7%	5.1%	3.5%	12.5%	100.0%
	Mitrovica	34.3%	36.4%	17.1%	6.4%	5.0%	0.7%	100.0%
	Prizreni	15.3%	21.5%	25.4%	27.7%	4.0%	6.2%	100.0%
	Peja	18.8%	43.8%	7.3%			30.2%	100.0%
	Ferizaj	9.0%	65.8%	18.9%	2.7%		3.6%	100.0%
	Gjakova	9.4%	22.2%	47.9%	11.1%		9.4%	100.0%
	Gjilan	14.4%	69.2%	11.5%	1.0%	1.0%	2.9%	100.0%
Total		23.9%	35.8%	20.0%	8.8%	2.4%	9.1%	100.0%

Polici								
								Total
		Shumë shpesh	Shpesh	Ndon-jëherë	Rrallë	Asnjëherë	Nuk e di	
Regjioni	Prishtina	9.1%	15.7%	24.0%	16.1%	24.8%	10.2%	100.0%
	Mitrovica	24.6%	22.5%	27.5%	18.8%	5.8%	0.7%	100.0%
	Prizreni	5.1%	15.2%	15.7%	33.1%	28.7%	2.2%	100.0%
	Peja	3.1%	6.2%	23.7%	27.8%		39.2%	100.0%
	Ferizaj	2.7%	14.3%	33.0%	43.8%	6.2%		100.0%
	Gjakova	6.0%	38.5%	38.5%	10.3%	2.6%	4.3%	100.0%
	Gjilan	3.8%	61.5%	30.8%	2.9%	1.0%		100.0%
Total		8.3%	22.9%	26.4%	21.7%	13.3%	7.4%	100.0%

Forca e Sigurisë së Kosovës

								Total
		Shumë shpesh	Shpesh	Ndonjëherë	Rrallë	Asnjëherë	Nuk e di	
Regjioni	Prishtina	2.4%	6.7%	10.2%	14.9%	51.4%	9.8%	100.0%
	Mitrovica	21.4%	13.6%	25.7%	19.3%	18.6%	0.7%	100.0%
	Prizreni	0.6%	2.3%	3.4%	19.2%	66.7%	5.6%	100.0%
	Peja			6.2%	19.6%	11.3%	18.8%	100.0%
	Ferizaj	1.8%	1.8%	2.7%	8.0%	83.9%	0.9%	100.0%
	Gjakova	6.0%	10.3%	12.0%	23.9%	41.9%	6.8%	100.0%
	Gjilan	1.9%	31.4%	48.6%	10.5%	3.8%	1.9%	100.0%
Total		4.8%	8.7%	14.2%	16.6%	43.2%	6.5%	100.0%

Administratë tatimore

								Total
		Shumë shpesh	Shpesh	Ndonjëherë	Rrallë	Asnjëherë	Nuk e di	
Regjioni	Prishtina	15.3%	16.5%	25.1%	3.5%	7.5%	32.2%	100.0%
	Mitrovica	26.8%	30.4%	24.6%	12.3%	5.1%	0.7%	100.0%
	Prizreni	11.2%	19.6%	39.7%	15.1%	7.8%	6.7%	100.0%
	Peja	4.2%	14.6%	15.6%	7.3%	1.0%	57.3%	100.0%
	Ferizaj	1.8%	16.2%	45.0%	27.0%	5.4%	4.5%	100.0%
	Gjakova	6.0%	16.2%	53.0%	15.4%	2.6%	6.8%	100.0%
	Gjilan	2.9%	56.7%	28.8%	6.7%	2.9%	1.9%	100.0%
Total		11.2%	22.9%	32.6%	11.5%	5.3%	16.5%	100.0%

Dogana

								Total
		Shumë shpesh	Shpesh	Ndonjëherë	Rrallë	Asnjëherë	Nuk e di	
Regjioni	Prishtina	18.0%	18.4%	22.0%	5.5%	2.7%	32.2%	100.0%
	Mitrovica	28.8%	33.8%	26.6%	6.5%	4.3%	0.7%	100.0%
	Prizreni	14.0%	39.3%	32.0%	9.0%	2.2%	6.7%	100.0%
	Peja	8.3%	28.1%	19.8%	4.2%		57.3%	100.0%
	Ferizaj	23.2%	50.9%	19.6%	6.2%		4.5%	100.0%
	Gjakova	9.3%	21.2%	46.6%	13.6%		6.8%	100.0%
	Gjilan	4.8%	61.9%	21.9%	7.6%	1.0%	1.9%	100.0%
Total		16.1%	33.7%	26.8%	7.4%	1.8%	16.5%	100.0%

Ndërmarrje publike								
								Total
		Shumë shpesh	Shpesh	Ndon-jëherë	Rrallë	Asnjëherë	Nuk e di	
Regjioni	Prishtina	21.3%	20.1%	18.9%	3.1%	2.8%	33.9%	100.0%
	Mitrovica	33.8%	28.8%	25.2%	9.4%	2.2%	0.7%	100.0%
	Prizreni	9.6%	25.3%	35.4%	15.7%	5.1%	9.0%	100.0%
	Peja	14.6%	38.5%	15.6%			31.2%	100.0%
	Ferizaj	9.0%	45.0%	36.0%	7.2%		2.7%	100.0%
	Gjakova	6.0%	17.9%	58.1%	10.3%		7.7%	100.0%
	Gjilan	3.8%	63.8%	24.8%	3.8%	1.0%	2.9%	100.0%
Total		15.3%	31.1%	29.5%	7.3%	2.0%	14.8%	100.0%

Spitale publike								
								Total
		Shumë shpesh	Shpesh	Ndon-jëherë	Rrallë	Asnjëherë	Nuk e di	
Regjioni	Prishtina	24.0%	21.7%	26.0%	4.7%	10.6%	13.0%	100.0%
	Mitrovica	34.1%	28.3%	29.7%	6.5%	0.7%	0.7%	100.0%
	Prizreni	15.7%	37.1%	30.3%	12.9%	2.8%	1.1%	100.0%
	Peja	11.3%	49.5%	16.5%	7.2%		15.5%	100.0%
	Ferizaj	11.7%	70.3%	9.9%	5.4%		2.7%	100.0%
	Gjakova	17.1%	19.7%	42.7%	13.7%		6.8%	100.0%
	Gjilan	1.0%	33.3%	60.0%	2.9%	1.0%	1.9%	100.0%
Total		18.1%	34.4%	30.1%	7.6%	3.4%	6.4%	100.0%

Shkolla publike								
								Total
		Shumë shpesh	Shpesh	Ndon-jëherë	Rrallë	Asnjëherë	Nuk e di	
Regjioni	Prishtina	13.7%	16.1%	25.1%	9.8%	20.0%	15.3%	100.0%
	Mitrovica	25.9%	21.6%	33.1%	14.4%	5.0%		100.0%
	Prizreni	9.0%	16.9%	34.8%	26.4%	6.7%	6.2%	100.0%
	Peja	3.1%	11.3%	14.4%	12.4%		58.8%	100.0%
	Ferizaj	7.3%	57.3%	28.2%	7.3%			100.0%
	Gjakova	5.9%	22.0%	18.6%	41.5%	5.9%	5.9%	100.0%
	Gjilan		16.5%	70.9%	9.7%	1.9%	1.0%	100.0%
Total		10.5%	21.8%	31.2%	17.1%	7.9%	11.5%	100.0%

Universitet publike								
								Total
		Shumë shpesh	Shpesh	Ndonjëherë	Rrallë	Asnjëherë	Nuk e di	
Regjioni	Prishtina	18.4%	18.0%	20.8%	9.4%	18.4%	14.9%	100.0%
	Mitrovica	33.3%	26.1%	25.4%	13.8%	1.4%		100.0%
	Prizreni	9.0%	15.2%	38.2%	22.5%	5.6%	9.6%	100.0%
	Peja	6.2%	36.1%	17.5%	6.2%		34.0%	100.0%
	Ferizaj	8.2%	56.4%	31.8%	3.6%			100.0%
	Gjakova	10.2%	12.7%	20.3%	41.5%	5.9%	9.3%	100.0%
	Gjilan		19.2%	74.0%	3.8%	1.0%	1.9%	100.0%
Total		13.6%	24.1%	30.9%	14.6%	6.7%	10.1%	100.0%

Ndërmarrje private								
								Total
		Shumë shpesh	Shpesh	Ndonjëherë	Rrallë	Asnjëherë	Nuk e di	
Regjioni	Prishtina	10.6%	11.8%	29.8%	5.9%	4.7%	37.3%	100.0%
	Mitrovica	25.2%	18.7%	35.3%	12.2%	7.9%	0.7%	100.0%
	Prizreni	3.9%	12.4%	36.5%	23.6%	19.7%	3.9%	100.0%
	Peja	3.1%	5.2%	6.2%	11.5%	1.0%	72.9%	100.0%
	Ferizaj	2.7%	28.2%	48.2%	15.5%		5.5%	100.0%
	Gjakova	4.3%	16.5%	60.0%	10.4%	0.9%	7.8%	100.0%
	Gjilan		1.0%	53.3%	39.0%	2.9%	3.8%	100.0%
Total		8.0%	13.4%	37.5%	15.5%	6.3%	19.2%	100.0%

Organizata jo-qeveritare								
								Total
		Shumë shpesh	Shpesh	Ndonjëherë	Rrallë	Asnjëherë	Nuk e di	
Regjioni	Prishtina	8.2%	11.4%	40.8%	5.5%	6.7%	27.5%	100.0%
	Mitrovica	21.6%	21.6%	30.2%	13.7%	12.9%		100.0%
	Prizreni	9.6%	10.2%	31.1%	31.6%	14.7%	2.8%	100.0%
	Peja		2.1%	22.7%	12.4%	1.0%	61.9%	100.0%
	Ferizaj	2.7%	8.1%	29.7%	52.3%	3.6%	3.6%	100.0%
	Gjakova	3.4%	15.4%	58.1%	12.8%	2.6%	7.7%	100.0%
	Gjilan	1.0%	2.9%	61.5%	30.8%	1.9%	1.9%	100.0%
Total		7.6%	10.9%	38.8%	20.6%	7.1%	15.0%	100.0%

Parti politike								
								Total
		Shumë shpesh	Shpesh	Ndon-jëherë	Rrallë	Asnjëherë	Nuk e di	
Regjioni	Prishtina	38.8%	23.1%	25.1%	3.9%	0.4%	8.6%	100.0%
	Mitrovica	38.1%	25.9%	27.3%	7.2%	1.4%		100.0%
	Prizreni	14.5%	22.3%	42.5%	15.6%	0.6%	4.5%	100.0%
	Peja	13.4%	54.6%	11.3%	1.0%		19.6%	100.0%
	Ferizaj	60.4%	31.5%	5.4%	1.8%		0.9%	100.0%
	Gjakova	14.5%	54.7%	20.5%	6.8%		3.4%	100.0%
	Gjilan	4.8%	74.0%	19.2%	1.9%			100.0%
Total		27.9%	36.3%	23.9%	6.1%	0.4%	5.4%	100.0%

Opinionet e qytetarëve rreth sjelljeve të ndryshme korruptive sipas regjioneve

Mjeku që kërkon para/dhuratë në shkëmbim të mjekimit/trajtimit më të mirë							
		Gjithmonë e pranueshme	Kryesisht e pranueshme	Ndonjëherë e pranueshme	Nuk është e pranueshme	Nuk e di	Total
Regjioni	Prishtina	0.8%	4.3%	4.3%	87.5%	3.1%	100.0%
	Mitrovica	1.4%	9.3%	10.7%	78.6%		100.0%
	Prizreni	17.3%	35.2%	13.4%	30.2%	3.9%	100.0%
	Peja		11.2%	24.5%	51.0%	13.3%	100.0%
